

“... Ç’është Shqipëria e tregon më shumë një kullë malësore, se të gjitha bulevardet e kryeqytetit” - **Indro Montanelli**



# Dukagjini

**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XII i botimit, nr. 132, tetor 2014**  
 Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## “KUR TË GJITHË E KANË GABIM, ATËHERË TË GJITHË KANË TË DREJTË!” 2

(SHPREHJE E URTË KINEZE)

M'u desh të “arratisesha” deri në Kinën e largët për të huazuar këtë shprehje të kahershme kineze. Ajo që na ndodh, ne shqiptarëve, është më shumë e çuditshme për nga lloji se si ndodh, sesa nga befasia që sjellë, për vetë faktin se, për ne nuk përbën befasi asgjë mbi këtë tokë. Të mësuar si mos më keq përsa i përket vetëpërbajtjes, instiktiv deri në atë masë, saqë flakë e barot i mbijnë në të njëjtin xhep, të bymyer deri në palcë me urrejtje pandemike, të gatshëm në çdo moment për t'u vënë kolonë për një, si dikur motit, ende nuk po mundemi me pas edhe zëra ndryshe, sepse turmat irrituar të marrin përpara pa të kontrolluar aspak “certifikatën” e arsyes. **Editorian nga LAZËR KODRA**

## Eva Vocaj - pedagoge dhe këshilltare në qeverinë e shtetit Kanadez 5

Shoqërisë tonë i duhen njerëz me vlera të larta morale, humane, profesionale, të përgjegjshëm e të aftë për sfida në shërbim të familjes, shoqërisë duke u shëndërruar në model jo vetëm për komunitetin ku punon e jeton, por dhe për shoqërinë në përgjithësi. Këta individë me vlera, që me heshtje krijojnë e rrisin personalitetin, këta familjarë shembullorë, bashkëpunues e integruer duhet evidencuar, njohur, respektuar e vlerësuar me forma e metoda ku individi të ndjehet mirë e shoqëria të gëzohet, që në gjirin e saj gjënden e do të gjënden vlera të domosdoshme për ta shpënë parpara.



## IDENTITETI NACIONAL SHQIPTAR 6

Nikë Gashaj\*

Një ndër faktorët më me rëndësi të përcaktimit të identitetit kombëtar është përdorimi i gjuhës amtare (private, publike dhe zyrtare) dhe arsimimi nacional. Njohjet historike tregojnë se themelimi i shkollave në trojet shqiptare u bë gjatë mesjetës me nismën e urdhrave kishtarë, sidomos të urdhrit dominikan. Një aktivitet i këtillë filloi së pari në Ulqin rreth vitit 1258, në Kotorr më 1266, në Durrës më 1278, në Shkodër më 1345 dhe në Tivar nga gjysma e dytë e shekullit XIV.

## Muzika qytetare shkodrane 2014 9

Në jetën e përditshme të qytetit të Shkodrës, kënga popullore shkodrane është gjithmonë e pranishme, si një ushqim shpirtëror e frymëzues, sepse kënga dhe humori janë pjesë e pandashme e banorëve të këtij qyteti.

Organizohen çdo vit koncerte, spektakle, sofrat me këngë dhe humor, por të gjitha në performancat e tyre kanë një bazë të vjetër tradicionale që në kulturën shpirtërore njihet si ahengu shkodran.

“Ahengu Shkodran” gjithmonë spontan, që në fillimet e tij, kur djem dhe burra të dashuruar pas muzikës, zejtarë, çirakë, por edhe të shkolluar mblidheshin pas punës, krijonin, kompozonin, interpretonin këngë që lindnin nga shpirti i tyre prej artisti dhe që si një lajm i mirë bëheshin përnjëherë pronë e kulturës së qytetit, duke u interpretuar jo në skena madhështore, por në oborre dasdash, në çardaqe gëzimesh familjare, e pse jo edhe në lokalet luksoze të kohës.



## Martin Camaj e letërsia shqipe 3

Cilindo lexues i mirëfilltë i letërsisë shqipe t'i ketë buzëqesh fati për me lexue poezit a prozen e Martin Camës e bekon rastin e fillimit të njohjes me Korabin e letërsisë shqiptare. Gjatë leximit të kësaj krijimtarije lexuesat shquejnë qartë bashkpunimin ngushtë të frymëzimit...



## GRUPI I VEPRIMIT LOKAL “BJESHKET E NAMUNA” NE VALBONE 11

Mundësoi Botimin:  
**GJERGJ LEQEJZA**

**Ma.di.sh** **Kimay**  
 PRODUCTION Produzione Giacche

# “KUR TË GJITHË E KANË GABIM, ATËHERË TË GJITHË KANË TË DREJTË!”

(SHPREHJE E URTË KINEZE)

editorial nga LAZER KODRA



gjetur filin e zgjidhjes, jo vetëm në këto vite paçamuri, por as ndër disa shekuj me radhë.

## QAJMË TË “VOGLIN” E BËJMË TË “MADHIN!”

Sa herë që bie fjala për ngjeshje me kurrizin e Evropës, ne fillojmë e ‘qajmë’ si të vegjël. Po ne nuk na donë askush! Po ne jemi të vegjël! Po ne na u kanë hëngër të drejtat! Po ne na kanë copëtuar! Po ne...! Po ne...! E qindra “po ne” qarqojnë mendjen tonë në shkretim e sipër. Aq kontradiktor jemi në vetvete, saqë menjëherë mjafton të “dredhim timonin” e të fillojmë: Ne jemi evropian! Ne jemi më të vjetrit në Evropë! Ne jemi njisha! Ne kemi gjuhen më të vjetër! Ne kemi flamurin Kuq e Zi! Po kjo drejt Evropë a ka ndonjë gjë më të mirë se ne? Atëherë çfarë na shtyn të shkojmë drejt saj? E gjitha kjo (e kam thënë edhe më parë) vjen si rezultat i mossinkronizimit të asaj që bëjmë me atë që themi. Dhunti, të pakrahasueshme me askënd, disponojmë në qenien tonë përsa i përket aftësisë për të qarë si të vegjël e për të bërë si të mëdhenj. O Zot na ruaj nga dëliri i madhësisë dhe përlulja deri në puthakëpucë ndaj Evropës, që për ne përben një

Engjëll në fjalë e një Dreq në mendje.

## RREMBENI DARËT/SULUNI TRIMA/HOQËT GOZHDËN/DOLI VRIMA!

Shumë vite më pare, rreth vitit 93, Dritëro Agolli iu drejtua turmave me këtë poezi katërvargjesh, por me peshë katërttonësh. Dhe e vërteta e këtyre vargjeve nuk vonoi shumë, që të bëhej realitet i hidhur asokohe. Turmat e kuptuan, por vonë. Aq vonë saqë këmbët u “digjnin” nga përcëllimi që i kishin bërë tokës së tyre. Asaj toke, për të cilën betoheshin e perbetoheshin deri në një lloj dashurie-manierë. Ato që ndodhën në Beograd, ishin për të thënë: Ruajna Zot! Mënyra se si u trajtua nga ana jonë, ishte për të thënë: Pse na vrave Zot!? E po të degjonte Zoti, do të përgjigjej: -Fitoren e vetme e kthyet ju vetë në humbje të meritueshme! (Priti turmat bre!) Kurrë nuk do ta kisha besuar, se të gjithë ne do ta bënim “gryqin” në atë formë sa qesharake aq edhe shterparake, siç u vertetua së fundmi, pa pasur askënd përballë, përveç një “spine” të mbërthyer vetem e vetem në nacionalizem që na furnizonte “bateritë”. Kush pati pak guxim u detyrua të kalonte kufirin shqiptar për të dhënë intervistë mbi ngjarjen në një gazetë të një shteti tjetër. Po kjo a është

dhunë ndaj bashkëatdhetarit tonë!? Çudia nuk mbaron këtu. Media e shkruar dhe ajo elektronike “zhyten pompat” në pusin e turbullt e furnizuan auditorin për disa ditë e javë rresht, herë me mllef, herë me mungesë arsyeje, herë me urrejtje fundamentaliste e hera-herës duke përsëritur të njëjtat gjera deri në monotonin shkatërruese. Edhe kjo çudi qoftë e shkuar. Po këta të spektakleve dhe emisioneve mbi artin ç’patën! Nuk kërceve bukur, por do të japë pesë pikë pasi kishe mbështjellë flamurin Kuq e Zi, ky ishte vlersimi që njëleshko i importuar nga përtej kufirit i bën një çifti në një emision-spektakel. Dhe keshtu, pafundësisht ndër ekranet tona, artin e mbysin idiotësi të tilla për disa ditë me radhë.

## A MUD TA TËRHEQIN KONTINENTIN?

Ne e kemi flamurin, sa më të bukur s’ka. Këngë për të kemi më tepër se Evropa e Amerika të marra së bashku. Flamuri ynë është i vlerë dhe i dliër dhe plot simbolikë. Por duhet ta dimë se gjëra të tilla nuk hidhen në treg çdo ditë. Ato ruhen në ekuivalencë të vlerës që kanë. Mos ta hedhim shpesh në “treg”, sepse vetëm e zhvlerësojmë dhe e zhburrojmë. Nuk është formuar lehtë si i tillë e nuk duhet të përdoret edhe për “qeleshe qerosi”. Më në fund të fundit, gjërat

rrodhën si rrodhën. Ne humbën shumë. I bëmë “gryqin Evropës, UEFA-s”, i shamë nga nëna dhe motra edhe Evropën edhe Platininë. Ky ishte rasti më i mirë për të shfryrë mllefin anti-evropianët, që nuk janë të paktë në këtë vend, gjoja se tashmë kemi arsye! Po cila është zgjidhja në dilemën: Duhet t’u ngjasojmë ne evropianëve, apo duhet të reformojmë ne Evropën? Mos harroni, këtu tek ne, ka një “kavo” shumë të vjetruar që gjithnjë përpiqet t’a tërheqë kontinentin në kahen e kundërt. Ky rast ishte preteksti, nesër do të përpiqen ta trumbetojnë si shkak, e pasnesër një dreq e di ...! Duhet të jemi të vetëdijshëm se, përveç flamurit kemi edhe gjëra të tjera. Nuk mund të jemi evropian, nuk mund të jemi artistë, nuk mund të jemi të fuqishëm, nuk mund të ecim përpara e te tjera vetëm për faktin se kemi flamurin Kuq e Zi! Kush e tund dhe e shpalosë Atë fare lehtë, aq ka edhe vlersimin në thelb, për vlerën e tij. “Kur të gjithë e kanë gabim, atëherë të gjithë kanë të drejtë!”. Kjo shprehje kineze, për mua, është e vetmja përligjje për mënyrën se si reaguam ne. Në fund të fundit, ndoshta, edhe një njeri i vetëm mund të ketë të drejtë.

## FLUTURIMI I SHQIPONJËS AUTOKTONE

SHQIPONJA ARBËRORE, PASI BËRI NJË FLUTURIM RRETH E RROTULL GADISHULLIT ILIRIK, U NDAL TEK LUMI I LASHTË ILIR TUNA (DANUBI) DHE ME FUQINË DHE FRESKINË E ALPEVE SHQIPTARE, U LËSHUA ME VRIK NGA QIELLI AUTOKTON, KUR PA SE MIJËRA ÇAKAJ TË STEPAVE NGA KARPATET PO SULMONIN NJË GRUSHT LUANËSH ILIRO ARBËROR.

... PËRLESHJA TITANIKE FILLOI! PASHA TOKË E QIELL U BËNË BASHKË TOKA DHE QIELLI, SHQIPONJA DHE LUANËT AUTOKTONË. ÇAKAJTË NGA STEPAT U STEPËN DHE BOTA E HABITUR DHE E MAHNITUR PY-

ETI? ÇËSHTË KJO FUQI HYJNORE QË TREMBI PËR VDEKJE GJERË NË PALCËN BARBARE MILIONA ÇAKAJ TË ETUR PËR GJAK DHE TOKA ARBËRORE.

SAKAQ, ZOTI ILIRO ARBËROR BËRI BASHKË NË NJË: PIRRON, GJERGJ KASTRIOTIN, ABDYL FRASHËRIN, ISMAIL QEMALIN, ISA BOLETININ, ADEM JASHARIN, TAULANT XHAKËN, LORIK CANËN, ANDI LILËN, BEKIM BALËN, ETRIT BERSHËN DHE SHOKËT E TYRE PËR TË DËSHMUAR FUQINË MITOLOGJIKE TË AUTOKTONISË SË GADISHULLIT ILIRIK.

HAJRIZ SEJDIU,  
PRISHTINË, TETOR 2014



# Martin Camaj e letërsia shqipe

Cilitdo lexues i mirëfilltë i letërsisë shqipe t'i ketë buzëqesh fati për me lexue poezit a prozen e Martin Camës e bekon rastin e fillimit të njohjes me Korabin e letërsisë shqiptare. Gjatë leximit të kësajë krijimtarije lexuesat shquejnë qartë bashkpunimin e ngushtë të frymëzimit e të kritikës aq të zotnueme prej autorit sa në kristalizimin e shkrimeve të tija nuk mund të vrehet as pikla ma e padukshme mbi atë kristal të dlirtë si rrexa e diellit. Në sajë të këtij bashkpunimit, Martin Camaj i përket atij numri shumë të vogël të shkrimtarve botnor qe nuk u shkon fare përshtat thanja e famshme: "Edhe Homeri flenë!" Fltrat qe e çuen këtë synim në kulmin e qëllimit qenë talenti i jashtzakonshëm në dobi të mrekullueshme në krijimtari e prirja po aq e fuqishme në hulumtimin e vlerave gjuhësore në përshtatshmëni të plotë me kerkesat e talentit që ngulmon majet ma të nalta të përsosmënisë letrare. Duke e ditë se instrumenti ma i domosdoshëm i shkrimtarit ashtë gjuha e përzgjedhi shqipen shkrimeve të veta si përzgjedh virtuozi instrumentin muzikor për me rregjistruer veprat ma madhore të muzikës. Kjo përzgjedhje u jep shkas pyetjeve: Cilat janë të metat e gegnishtes që e "Justifikuen nxjerren e sajë jashtë ligjit?!

Cilat janë vlerat e epërsisë së "Standardit" ndaj gegnishtes?!

Si mundet me u konsiderue letrare shqipja e përdorimit të sotëm kur thesari i pa skajshem gjuhsorë si paskajorja e kur të gjitha kryeveprat e letërsisë shqipe janë të shkrueme në gegnisht përfshi edhe përkthimet e veprave ma madhore të letërsisë botnore si "Komedia Hyjnore", "Iljada e Odiseja" e shumë të tjera. E si do të mund të arriheshin këto lartësi artistike pa shqipen ma të përkryeme? E kush nuk e njeh defiqitin e bujshëm që psoi sterpërkthimi i Iljadës në të ashtuquejtënen shqipe standarde?! Heshtja ndaj këtyne pyetjeve a nuk ashtë pellgu ma i thellë i turpit ku kundërshtarët e vlerave të gjuhës shqipe dhunimi i të cilave i banë me qenë vetëm shtetas Shqipnije pa një pikël sedër pranojnë me u zhyt në at pellgë turpi se me iu përgjegjë këtyne pyetjeve. Nëse talentin e krahasojmë me një fabrikë të mrekullueshme randsia kryesore qëndron në gjetjen e landës që e nderon prodhimin e asajë fabrike. Në rastin tonë landa ashtë pasunia gjuhsore e talenti shëndrruesi i kësajë lande në art. Këtë të vërtetë na thekson dukshem edhe vetë Martin Camaj në romanin e tij perlë "Rrathet" ku thotë: "Vetëm talenti nuk mundet me të ba shkrimtar". E ka të drejtë.

Intelektual mundesh me qenë edhe pa qenë shkrimtar, por shkrimtar nuk mundesh me u ba kurrsesi pa qenë intelektual. E jo ai tip intelektual që disa e kujtojnë sinonim me i dijshtëm, por ai intelektual, intelektin e të cilit e përbajnë virtyti e kultura. Ky intelektual i frymëzoi Sokratit thanjën: "Pa një shpirt të madh nuk mundesh me ba vepra të mëdha". E në vepren e Martin Camës përveç mjeshtrit të madh të evolucionit ma të dukshem gjuhsor të shqipes shohim edhe shpirtin qe përkon përsosmënisht me artin e tij. Në romanin "Rathet" qe ashtë modeli ma shembullor i prozës shqipe e përshkruen komunizmin shqiptar pa e përmend fare fjalen komunizëm e quen vetëm "Sistem" si të donte me na thanë se fjala komunizëm nuk meriton me egzistue. Synimet e talenteve te tija janë me kontribue sa ma dobishëm në ngritjen e nivelit artistik të shqiptarve. Ai beson se numrin të lexuesave shqiptarë që komunizmi nuk kishte arritë ende me ua helmatisë shijen e ardhmja do tu shtonte dukshëm lexuesat të përgatitun për veprat e veta. Ngase fundi i komunizmit mendonte ai do te merrte me vehte edhe mikrobet anti art. E vetmja gja që nuk kishte si me e marrë me mend ishte pandryshshmënia e kushdi derikurshme e shijes së gatue me brumin e krundeve të propagandës komuniste siç i nevoitej rrealizmit socialist. Psedoarti i prodhuem nga kjo rrymë e cila ngrihej si perde e hekurt midis popullit e artit sepse komunizmi i friksohej artit si ma të rrezikshëmve anmiq të tij. Si e ka frigë edhe sot e kësajë dite artin e Martin Camës ngase mundet me e ngritë nivelin e lexuesave shqiptarë aty ku t'i braktisë me neveri zhgarravinat e psedoartit komunist e neokomunist shqiptarë, i cili moderimin e tij fare të vockël mundohet me na servirë si një ndryshim tepër të madhë. Por ata qe nuk e gelltisnin dot këtë llojë gënjeshtre i akuzojnë randë gjymtuesat e shijeve të tyne sepse komunizmi ia ngjiti psedoartit artë ashtu si ç, mund t'i ngjitet një vaje të shëmtueme Bukurije. E për me ia shtij popullit sa ma në gjak e quejti: "Artë për popull" që mund ta shijonin "Masat e gjëra popullore" Ndërsa artit të vërtetë i vuri etiketa përcudhuese si "Art borgjez", "dekadent rrevizionist" e dreqi e merr vesh sa kësi etiketash. Kjo gjendje kulturore u ba imperativi kadegorik i nevojës ma të domosdoshme me e mbushë atë shterbësi me letërsinë e madhe të gjysmës së dytë të shekullit njizet si vazhdimsi cilësore të gjysmës së parë të atij shekull e me një rritje të shkëlqyeshme të nivelit gjuhsorë.

Dikush për mos me ua prishë disave e cilëson Martin Camën si "Shkrimtari ma i madh i mërgimit", por si ata që mundohen me e nda letërsin shqipe dyshë në të ashtuquejtun letërsi e realizmit socialist dhe në letërsi të mërgimtarve letërsi shqipe quhet ajo që shkruen shqiptarët e kudondollun. Para se të japë këtë konsideratë duhet të dij se Martin Camaj e ka vendlindjen në Temal të Shkodres. Dikush e konsideron avantazh demokratik qoftë edhe përmendjen e Martin Camës. Unë them se merita nuk jepet grimca grimca se ashtu grimcohet merita e merita e grimcueme ndihet ma e fyeme se mos me u marrë fare me te. Zbutja qe nuk ia heqë padrejtsisë rrokjen e parë quhet ironike. E ironia ashtë ofendimi ma i neveritshëm. E kjo ironi drejtohet kah ai shkrimtarë që me artin e tij synon me edukue popull për art e jo me ba "Art për popull" siç e quente komunizmi psedoartin. E këtë synim drejtuesat e sotëm të kulturës shqiptare e konsiderojnë siç ashtë në të vërtetë zhdukës i psedoartit. Ndokush mundet me më thanë: Martin Camaj u vlersue me titullin "Nderi i Kombit" E unë u pyes: Sa përkon ky titull me vlersimin real qe i bahët veprës së Martin Camës?! Në heshtjen e atyne që bajnë sikur e nderojnë Martin Camën ashtë edhe vetë profesorati i universitetit "Luigj Gurakuqi" e kjo u pa fare qartë në kumtesat e referatet e mbajtun në përkujtimoren e këtij autor, ku secili kumtesmbajtës elozhoi kontributin i tij të jashtzakonshëm në gjuhsinë shqiptare e me aq epitete sa me të thanë mendja memzi kishin pritë me shkruer shqipen e përdorun në shkrimet e tija e megjithketë u vu re një kujdes i sterpepruem në rrespektimin e normave të shqipes së përdorimit të sotëm. Kur iu dha fjala auditorit unë bana këto pyetje: Pse nuk shkroi Martin Camaj në shqipen e përdorimit të sotëm? Me që qenka gjuhtari i atij nivel ku e theksuet ju, pse nuk shkrueni edhe ju në shqipen e tij? Pas një pritje të tejzgjatun që la me kuptue mungesen e përgjegjeve u detyrova me e ndërpre atë pritje që do te ishte e pa fund. Kur po dilnim nga salla një i pa njohun më foli disi dhimbshem: Martin Camaj ashtë demeku i nderimit të tyne. E ky demek mund të konsiderohet privilegj në krahasim me rrefuzimin që i bahet nga secili drejtues i medjes elektronike me i kushtue qoftë edhe vetëm një çerek ore vlerave të krijimtaris së tij. Te njëjtë pengesë ndesh edhe në medjen e shkrueme. Me të ba me besue se ky qëndrim ka me qenë trashigimia ma e gjatë e shqiptarve. Tue u mundue me u çfajsue

me të vetmin justifikim bajat me mos përdorimin e kësajë shqipe zyrtare që sipas tyne do ta bante të kuptueshëm nga të gjithë shqiptarët kur shqipja e tij ashtë ma e kuptueshmja nga çdo lexues i nivelit të dejë për leximin e atyne shkrimeve. Fjalët e tija më kujtuen kumtesen e mbajtun nga krye gjuhtari jonë Eqerem Çabej në kongresin komunistogjuhsor të 1972. Ajo kumtesë për kedo që din me e lexue tregon se firma e Çabejt në atë vendim antishkencor të atij kongres e vuni kerecnimi. Nëse nuk do të ishte kështu Martin Camaj si gjuhtar e si autor i gramatikës ma të përparueme të shqipes nuk do të pranonte kurrën e kurrës me iu kundërvu argumentave shkencor të Eqerem Çabejt. Por urrejtsat të thesarit të gjuhës shqipe shkëlqimi i të cilit u vret sytë e përdorin firmën e imponueme të Çabejt si justifikim drejtsije i atij vendim dhe e shtremnojnë në mënyrën ma djallzore kumtesen sfidë tue i mbulue me terrin ma të dendun të inforimimit fjalët e kriyegjuhtarit "Standardizimin e një gjuhe mbeshitet kryesisht në letërsinë ma të zhvilluar të një vendi si ndolli me Toskanën e Dantes e të tjerëve shkrimtar të asajë krahine. Ose standardizimin e vendos politika."

Këto fjalë të Eqerem Çabejt janë të ngjashme me ato të guximit të Galileut, megjithkëte Çabej nuk mundi me ia flijue jetën fjalëve: "E pur si muove." Tash nën moton e së kaluemes "Komunistat nuk dorzohen" në vjetorin e 2010 kur një grup gjuhtarësh po ndërmerre nismen për pasunimin e shqipes standarde, friga i një njisimit shkencor të gjuhës shqipe bani me ra në ujdij 40 të përmendun në letërsi, histori e në fusha tjera u banë barrikadë mbrojtse të "standardit" pa e justifikue at mbrojtje s'paku as me ato gënjeshtra që do t'i tingllonin disi të gëlltitshme ma injorantave. Kjo deklarata të nxitë me pyet: Si ka mundsi të jeshë edhe intelektual edhe mohues i vlerave të arsyetimit që janë e vetmja bazë e intelektit?! Ne munden me na shtij në Europë edhe pa ia shërue vehtes këto mikrobe kaq të damshme, por kështu ne hym vetëm gjeografikisht e jo kulturalisht, bahemi njollë në mozaikun e qytetnimit. Pjesë e meritue me e qytetnimit europjan mund të bahemi kur në pjestalin e kulturës Europiane të vemë veprat e Martin Camës e të paraardhsave të tij që e meritojnë vendin në atë pjestal.

Përgatitë nga **Gjok Vata**,  
"Krenaria e qytetit të Shkodrës"

# U nda nga jeta Mark Kapaj

Lindur në fshatin Toplanë, në një familje të mëkëmbur ekonomikisht, punëtore, e ndershme dhe mikpritëse, me 17.03.1935 . E filloi jetën dhe veprimtarinë e tij shoqërore, private dhe familjare në një periudhë të vështirë që kalonte vendi, përgatitja e vendit për Luftën II Botërore. Në një fshat malor krejtësisht të izoluar, pa asnjë lloj infrastrukture dhe një popullsi tërësisht analfabete si në mbarë Shqipërinë.

Marku u rrit dhe u edukua në mjedisin e tij familjar, në gjirin e një familje të madhe patriarkale, me shumë fëmijë, që merrshin me bujqësi dhe blegtori. U edukua me ndjenjën dhe respektin për punën, njerëzit, familjen dhe shoqërinë. Dalëngadalë tek Marku u formua një personalitet, një njeri me prirje përparimtarë që ëndërronte të punonte për një jetë me të kulturuar, me të ditur, me të pasur e të begatë. Periudha e fëmijërisë dhe e rinisë së Markut, ishte një periudhë e vështirë tranzicioni: fundi i mbretërisë së Zogut, lufta Nacional Çlirimtare dhe ajo Botërore. Çlirimi i vendit e vështirësitë në vitet e pas çlirimit, që direkt ndikuan edhe në mos arsimimin e plotë të Markut edhe pse tregonte prirje për të nxënë, inteligjencë e një mendje të mprehtë. Marku u rrit një burrë i mirë i Toplanës, Shoshit e të Dukagjinit, me punën e tij dhe të familjes, zëri e emri i tij u njohën jo vetëm në Toplanë, por në gjithë Dukagjinin edhe më larg. Mark Kapaj ishte një njeri i ndershëm, me moral dhe vullnet të madh, bujarë, fisnik, mikpritës. Ishte i pashëm e me një trup mesatar, i qeshur dhe shumë i komunikueshëm, me një gjuhë të pastër dhe të pasur me të gjithë dhe çdo kohë. Mark Kapaj ishte një organizator dhe drejtues i mirë. Si në kooperativë bujqësore ashtu në organet e pushtetit. Ishte i afërt me njerëzit, dëgjonte dhe respektonte mendimet e tyre, kishte aftësi

të mira organizative dhe ishte i papajtueshëm me vendimet dhe veprimet që binin ndesh me interesat e popullit dhe mirëqenien e tij. Ai ishte një demokrat i lindur në punë dhe në jetë. Edhe atëherë kur kundërshtia ishte dënuar rreptë. Marku me guxim dhe me argument bindëse dënonte shkurtrimin e oborrit dhe tufëzimin. Ai ishte i vetmi në Dukagjin që doli haptas dhe u ballafaqua gjerë në qendër për mos heqjen e derrave nga oborri kooperativist. Kjo iniciativë idiote e dalë nga komunist të papërgjegjshëm, nuk u zbatua



asnjëherë në Shosh, e kjo meritë tërësisht e Mark Kapës. Marku si Kryetar i Këshillit të Bashkuar, në Kooperativën e Shoshit u dallua si drejtues i drejtë dhe i pakorrptuar, njeri që zbatonte ligjin për të gjithë. Ishte tolerant, bashkëpunëtor, jo hakmarrës dhe një bashkëpunues me institucionet e tjera si Arsimi, Shëndetësia, Tregtia e te tjera, për mbarëvajtjen e punëve e përmirësimin e shërbimit ndaj popullit. Marku ishte me një vullnet që

të habite, punën e kryente me devotshmëri e përkushtim, punonte me orare e pa orare, lëvizte me këmbë nga një fshat në tjetrin, nga shkolla në shkollë, në qendrat shëndetësore. Koordinonte veprimet mes tyre, udhëzonte, por dëgjonte edhe hallet e problemet e tyre, për një shërbim sa më afër popullit e sa më të kualifikuar e shkencor. Edhe vetë Marku nuk reshti së punuari për ngritjen arsimore, kulturore dhe organizative. Vazhdoi pa ndërprerje shkollën e shkollimin, që për arsye objektive se kishte realizuar në rini, me vullnet dhe punë e arriti në vitet 1980 me përfundimin e shkollës së mesme. Marku ishte një shok i mirë, i dashur, i shoqërueshëm, fjale pak e punë shumë. Fliste ngadalë e qartë, dëgjonte secilin me vëmendje e vlerësonte mendimin e secilit. ishte njeri i qeftit, i kompromiseve dhe i mirëkuptimit. Kishte si pasion gjuetinë, për këtë shfrytëzonte çdo kohë të lirë që kishte, në çdo kohë të ditës e periudhë të vitit. Zagarët, "qentë e gjahut" të tij ishin bërë në qendër të kooperativës si pjesë e pandarë e jetës së tij. Këtu, të gjithë interesoheshin për t'i ushqyer e mbajtur. Çdo gjah i kapur, lepur, thëllëzë ishin ushqim për gjithë komunitetin e Ndrejajve, ku bashkëjetesa e puna këtu kishte sjellë mësues, mjek, agronom e te tjerë, që të gjithë punonin e jetonin si një familje dhe Marku ishte pjesë e këtij komuniteti me gjithë qenien e tij fizike, mendore e organizative. Marku si drejtues i pushtetit vendor për shumë vite, me punën dhe përpjekjet e tij ngriti në zona disa shkolla të reja, qendra shëndetësore e qendra tregtie në shërbim të popullit. Dërgoi për studime në shkolla të mesme e universitete me dhjetëra djem e vajza nga Shoshi e Toplana, e insistonte me ngulm pranë organeve eprore për rritjen e numrit të bursave e të drejtave të studimit për zonën. Asnjëherë ky njeri nuk kërkoj ndonjë privilegj për veten apo

familjen e tij. Marku ishte një bashkëshort i shkëlqyer, me Dranden kaloi një jetë të tërë bashkëshortor te shkëlqyer mbi besimin reciprok, dashurinë dhe mirëkuptimin. Ai ishte një baba shembullor, i dashur, i qeshur, i preokupuar për mirërritjen dhe edukimin e tyre edhe pse vete jetonte e punonte shumë orë larg familjes. Në martesën me Dranden ata patën 8 fëmijë, 4 djem dhe 4 vajza që sot të rritur të gjithë me familjet e tyre jetojnë në Shqipëri e jashtë saj. Vitet e fundit të jetës, Marku pati disa fatkeqësi njëra pas tjetrës, vdekja e nuses së djalit në Belgjikë, vdekja e djalit të nipit në Itali edhe ajo që e rendoj shumë ishte vdekja e djalit të madh, Gjinit, në moshe te re duke lënë gruan me dy fëmijë. Këto humbje e mërzen te mase dhe kjo mërzi e shoqëroi atë gjerë në çastet e fundit të jetës së tij.

Mark Kapaj vdiq me 03. 10. 2014, në moshën 79 vjeçare, por para kohe për familjen dhe ne shokëve e miqve të tij. Vdekja e Markut ishte një humbje e madhe për Dranden, bashkëshortin, për fëmijët dhe të gjithë të afërmit, por vdekja e Markut ishte humbje e madhe edhe për Toplanen, Shoshin dhe mbarë Dukagjinin, por ishte humbje për shokët dhe të gjithë ata që punuan dhe jetuan me Mark Kapen, se humbëm një njeri të urtë, të dashur, gojë ëmbël, i shoqërueshëm dhe komunikues me të gjithë. Humbëm një njeri që nuk mbante inate, nuk bënte padrejtësi, nuk ishte hakmarrës, por mbi të gjitha kishte bashkëpunimin, mirëkuptimin, besën, burrninë dhe besimin reciprokë. Të gjithë humbëm një njeri të mrekullueshëm.

Shpirti i tij pushoftë në paqe. Familjen e të afërmit zoti i forcoftë e i ruajt. Edhe shokët e miqtë do ta kujtojnë gjithmonë si një shok shumë të mirë dhe të sinqertë. Ishte për paqen, paqe e dritë pastë edhe në botën e përtejme.

Zef Fusha,  
Gjon Shtegu,  
Gjergj Prela,  
Ndoc Selimi  
e Zef Nika

## DOLI NUMRI NËNTË I REVISTËS "MALËSIA"

Doli nga botimi numri 9 i revistës për kulturë, shkencë dhe çështje shoqërore "Malësia" në Podgoricë, Mali i Zi, me një përmbajtje të pasur të punimeve shkencore dhe artikujve studimorë nga mbarë hapësira shqiptare dhe më gjerë. Në këtë numër kanë bashkëpunuar studiues nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Kroacia, Bullgaria, Italia dhe Mali i Zi.

Në rubrikën "kulturë" punimet e veta i kanë prezantuar 21 autorë: Akademik Aleksandër Stipçeviq "Shqiptarët për Arbreshët e Zarës"; Akademik Gjovalin Shkurtaj "Jup Kastrati, ky bir i madh i Shkodrës (1924-2003)"; Prof. dr. Matteo Mandala "Revista Hylli i dritës dhe Arbëreshët"; Prof. Dr. Anton Nikë Berisha "Jerina ase Mbretnesha e luleve-një kryepër poetike e Fishtës"; Prof. Dr. Valter Memisha "Matteo Mandala për leksikografinë në mjedisin arbëresh të Sicilisë"; Prof. Dr. Shaban Sinani "Motivi i krijesit të rruzullimit, prej P. Bogdanit e N. Ketës tek Pjetër Zarishi e At Gjergj Fishta"; Prof. Dr. Shpresa Hoxha "Gjuha Shqipe në qendrat tona televizive"; Prof. Dr. Zeqirja Neziri "Procesi i globalizimit dhe studimet historike letrare shqiptare"; Prof. dr. Josif Mita "Mbërritje të veçanta dhe të rëndësishme të gjuhtarëve Mazin & Savoia"; Prof. Dr. Fatbardha Hoxha "Afirmimi i identitetit etnokulturor dhe kombëtar të shqiptarëve"; Prof. as. Muharrem Jakupi "Romani "Kronikë në Gurë"; Prof. as. Dr. Mimoza Priku "Gjuha shqipe dhe sfidat e saj përballë multilinguizimit"; Dr. Griselda Doka "Realiteti jetësor në poezinë e Ali Podrimjes"; Dr. Zamira Shkreli "Faza të përvetsimit të leksikut nga të vegjlit"; Mustafa Spahiu "Kur kjason qumshti i kulluar i fëmijërisë"; Ma. Gabriela Minkova "Autori anonim ka vranë protagonisten e veprës së tij. Protagonistja jo anonime ka vranë krijuesin e saj"; Mr. Ragip Gjoshi "Shkolla e Stubës fillimi i arsimit shqip në Kosovë"; Ma. Luljeta Dushi "Fjalori Italisht-Shqip - I Luca da Monte Giove" (Dorëshkrimi i vitit 1848. ); Mr. Majlinda Bushaj-Mr. Marjan Lulgjuraj "Prof. David Luka-personalitet i shquar i gjuhës shqiptare"; Hilmi H. Kryeziu "Mustafa Spahiu, burim i

pashtershëm mirësie...".


Në rubrikën nga "historia" janë prezantuar tri studime shkencore: Prof. dr. Emine Bakalli "Revolucioni Kombëtar Shqiptar: Reflektime për lëvizjen e armatosur kombëtare për autonominë e Shqipërisë të vitit 1912"; Prof. Dr. Lush Culaj "Vrasja e Luigj Palajt sipas burimeve malazeze të vitit 1913"; Prof. Neki Babamusta "Çameria, problem ndërkombëtar që kërkon zgjidhje".

Një rubrikën "çështje shoqërore" janë botuar artikujt shkruar nga: Dr. Ermira Babamusta "Dita Botërore Humanitare: Homazh në përkujtim të masakrave në Kosovë"; Prof. dr. Kaloyan Metodiev "Gjenerata e vitit 1968: nga rebelimi i të rinjve deri në politikë"; Mr. Danja Sinanaj "Kisha dhe eutanazia-një konflikt modern"; Nora Kalaja, Kongresi Amerikan nderon Ermira Babamusten "Gruaja Humanitare Ndërkombëtare".

Ky numer mbyllet me recensione ose shqyrtime për disa botime aktuale të autorëve nga Shqipëria, Kosova, Kroacia dhe Mali i Zi, trajtuar nga Prof. dr. Simë Dobreci, Prof. dr. Halil Halimi, Prof. dr. Fiorella De Rosa, Dr. Vilma Proko, Dr. Kastriot Marku, Dr. Albana Aliu, Mr. Marash Dukaj, Mr. Sheremet Krasniqi dhe publicisti Sokol Demaku.

Redaksinë e revistës e përbëjnë një numër i njohur i intelektualësh nga rajonet e ndryshme shqiptare dhe me gjerë ballkanike: Ruzhdi Ushaku, Gjovalin Shkurtaj, Shpresa Hoxha, Zeqirja Neziri, Zef Mirdita, Rusana Bejleri, Emil Lafe, Emine Bakalli, Riza Rexha, Tomor Osmani, David Kalaj, Begzad Baliu.

Kryeredaktori i revistës është Nikë Gashaj. (e-mail: malesia@t-com.me)



2014



# Eva Vocaj - pedagoge dhe këshilltare në qeverinë e shtetit Kanadez

Shoqërisë tonë i duhen njerëz me vlera të larta morale, humane, profesionale, të përgjegjshëm e të aftë për sfida në shërbim të familjes, shoqërisë duke u shëndërruar në model jo vetëm për komunitetin ku punon e jeton, por dhe për shoqërinë në përgjithësi. Këta individë me vlera, që me heshtje krijojnë e rrisin personalitetin, këta familjarë shembullorë, bashkëpunues e integruues duhet evidentuar, njohur, respektuar e vlerësuar me forma e metoda ku individit të ndjehet mirë e shoqëria të gëzohet, që në gjirin e saj gjënden e do të gjënden vlera të domosdoshme për ta shpënë parpara.

Komuniteti ynë, edhe pse i shpërndarë në shtete e kontinente të botës këto vite tranzicioni, ka pse të krenohet dhe me kë të krenohet. Bijtë dhe bijat me gjak e prejardhje dukagjinase jo vetëm brenda atdheut, por edhe jashtë tij, po dallohen si sipërmarrës biznesi, po shkëlqejnë në auditorë, podiume skenash dhe ekranesh, në politikë e diplomaci, në sport, e të tjera. Pra, ka shumë e në çdo fushë, janë konkures, dhe na nderojnë në fuqishat ku ata operojnë. Por, tashmë është e nevojshme që ne ti njohim, por dhe të punojmë që edhe ata të njohin njëri-tjetrin.

Këtë radhë do të ndalemi të shkruajmë mbresat që na la në një takim znj. Eva Vocaj, me nënshitetësi kanadeze. Sapo të lexoni që Eva është e bija e Gjergj Vocaj, ndonjë do të thotë:

- S'ka si të ndodhë ndryshe, se familja e Vocajve është një dinasti vlerash, që në çdo brez vjen duke u rritur në çdo aspekt. Por jo, Eva, edhe pse lindur e rritur në Tiranë, edhe pse kishte mundësi të sistemohej në profesionin e saj, kërkoi të rrisë aftësisë të saj profesionale edhe pse vështirësitë e përgjegjësitë e dinte se ishin të mëdha. Eva është një njeri i qetë, mjaft e qeshur, me një të folur shkodrancelle të ëmbël, përhumbte në mendime teksa fliste për rrugën e saj të gjatë.

- Kam mbaruar shkollën e lartë për Gjuhë të Huaja, dega Frengjisht në Tiranë dhe kam punuar si pedagoge në këtë degë për disa vite. Ndryshimet që filluan të ndodhin me reformat në arsim kërkonin kurrikula të reja dhe e kisha të domosdoshme të vazhdoja kualifikimin tim jashtë shtetit. Kam aplikuar mbas shumë mundimesh, doku-

mentash, radhesh në ambasada se në ato vite ishte e vështirë për të marrë vizë. Mu aprovua në vitin 1999 kërkesa për të studiuar dy vite për master në Kanada. Mbarova Masterin dhe më pas, ndoqa për katër vjet të tjera Doktoraturën. Studimi im është përqëndruar në njohjen teorike të gjuhës shqipe, sepse atje njihet pak dhe dëshira ime ishte të kontribuoja në njohjen edhe atje të gjuhës tonë amtare. Tani unë jam petagoge e kësaj gjuhe në Universitetin Ikebeku-Montreal. Jam e aktivizuar edhe si Këshilltare në Ministrinë e Emigracionit dhe te Integritet të qeverisë Kanadeze.

Puna atje është me ngarkesë të lartë, por ajo përballon me përkushtim dhe profesionalizëm. Ndërkohë që puna është njëra anë, ana tjetër, madje më e rëndësishmja në jetë është familja. Për familjen e saj Eva flet e lumtur dhe me argumente e fjalë të zgjedhura si bashkëshorte dhe nënë e përkushtuar.

- Me bashkëshortin tim Nikolan, jam njohur gjatë studimeve. Ai është francez me origjinë, por lindur e rritur në Kanada.

Babai i tij ka ushtruar profesionin e kineastit dhe është i dalluar në punën e tij, kurse nëna e tij në radio televizionin shtetëror. Ndërkohë që gjyshi i Nikolas, ka qenë ndër kërkuesit dhe eksploruesit e njohur francez të floririt në shumë vende të botës. Janë njerëz të dashur, me kulturë të gjerë dhe të respektuar. Kam vajzën Silvi dhe djalin Mateus, që mësojnë shumë mirë në shkollë: vajza në klasën e shtatë dhe djali në të tretën. Flasin rrjedhshëm gjuhën time dhe e shkruajnë bukur atë. Bashkëshorti im i nxit të mësojnë gjuhën shqipe, por edhe ai vetë e flet dhe kërkon ta përvetësojë sa më mirë këtë gjuhë.

Ndërtimi i një jete të re, në një vend të panjohur më parë, ku nuk ka të afërm apo familjarë të saj nuk ka qenë e lehtë. Natyrisht që mënyrat e sjelljes, kultura, mënyra e jetesës, e të ushqyerit, të veshurit e plot gjëra të tjera në jetë ishin të ndryshme nga ato të vendit të vet. Por, Eva të flet edhe për integritetin e saj në jetën akademike në punë, por dhe në mënyrën e bashkëpunimit dhe mardhëniet me mjediset shoqërore e famil-

jare.

- Po sigurisht ndjehem e barabartë në çdo aspekt me koleget që janë dhe me karrierë më te gjatë se unë aty. Kam mardhënie shumë të mira me studentët e mi, duke aplikuar forma e metoda të larmishme bashkëpunimi, në interes të rritjes së cilësisë së punës në drejtimin shkencor e pedagogjik. Në Universitetin ku unë punoj ka pak shqipëtarë studente dhe jemi tre kolegë pedagogë nga Shqipëria. Takohemi shpesh



dhe kalojmë ndonjë pjesë nga koha e lirë. Edhe bashkëshortin tim Nikolan e kam prezantuar me patriotet e mi dhe i bën përshtypje që ne shqipëtarët jemi të lidhur me njëri-tjetrin, respektojmë dhe na merr malli për njëri-tjetrin, veti keto që janë të trashëguara tek ne në breza, ku në vende ndoshta më të zhvilluara kjo cilësi është më e parëndësishme. Pra, sit ë thuash, jam integruar dhe kam ndryshuar gradualisht duke ruajtur me fanatizëm vlerat dhe të mirat që i kam marrë nga familja ime në Shqipëri.

Edhe për natyrën, Eva flet për ato cilësi dhe ndryshime me natyrën shqipëtare me florën dhe faunën që aq shumë i vlerëson.

- Ndryshon klima e Kanadasë me klimën e vendit tonë. Flora dhe fauna atje janë më pak të larmishme. Ndryshon shumë me natyrën tonë mesdhetare dhe meqenëse më mungon mundohem të modifikoj, ti jap gjallëri ambientit përreth shtëpisë time. Unë banoj në shtëpi private, sigurisht të qetë dhe me çdo komoditet të nevojshëm. Më

pëlqen gjelbërimi, pemët lulet e çdo gjë që në Shqipëri janë të shumëllojta dhe gjenden kudo. Atje përpiqem edhe pse nuk është e lehtë, të krijoj variante dhe larmi me ato mundësi që të jep klima, përseri mbetem jo fort e kënaqur, por kjo nuk varet nga unë, për atë çfarë kërkoj.

Por, megjithëse e vendosur me punë dhe me jetesë, megjithëse ka krijuar një familje model, atje larg në Kanada, lidhjen me vendin e saj nuk e ka shkëputur asnjëherë. Lidhjen

limit tonë të gjithëanshëm. Ne kemi nevojë të bashkëpunojmë, të duam e të respektojmë njëri-tjetrin, panvarësisht se çfarë përfaqëson njeri apo tjetri, nga niveli ekonomik apo shoqëror duke parë vetëm përpara. Inteligjencën, iniciativën, zemërgjerësinë, besën, e cilësi të tjera duhet ti vemë në interes të zhvillimit dhe integritetit tonë, ashtu si vendet dhe nacionalitetet e tjera të zhvilluara – vazhdoi ajo.

Eva Vocaj është një pasuri, një vlerë, një model i një personaliteti me formim të gjithanshëm intelektual e profesional e thjeshtë dhe e pasur në shpirt. Ajo është një ambasadore e jona, model i njeriut që nuk harron nga vjen e sigurtë dhe e vendosur në rrugën nga shkon. Është pikërisht kjo bijë e Alpeve Shqiptare (fshati Plan e lagjes Thani, të komunës së Pultit), e cila jo vetëm që ka ndërtuar një familje model, por përcjell në vendin ku punon e jeton gjithë anët më të mira të vendit të

vet: u ka mësuar bashkëshortit e fëmijëve gjuhën e nënës, jep kontributin e saj në pasqyrimin e vlerave të vendit tonë dhe në njohjen e komunitetit ku jeton me këto vlera të veçanata. Nga ana tjetër, ajo mban lidhje të forta e të qëndrueshme jo vetëm me njerëzit, por edhe me vendin. Kur vjen në Shqipëri shkon nga jugu në veri, duke pushuar dhe eksploruar. Nuk shkëputet kurrësi nga vendlindja, por që në Kanada bën plane për të vizituar ato vende aq piktoreske. Kjo bën të mundur vazhdimësinë, që edhe fëmijët e saj të jenë të lidhur me origjinën e tyre dhe të mos e harrojnë atë asnjëherë. Bija dhe bij të tillë të vendit tonë, janë një krenari e ligjshme për këdo, për më tepër për Dukagjinin e dukagjinasin!

I urojmë Evës dhe familjes së saj suksese në punë dhe në jetë. Urojmë që vizitat në vendin tonë të jenë të shpeshta, ku të shkëmbejmë përjetime, përvoja dhe mundësi bashkëpunimi.

Përgatitë nga  
Prof.as.dr. Zef GJETA  
dhe Zef BARI

# IDENTITETI NACIONAL SHQIPTAR

Nikë Gashaj\*

Një ndër faktorët më me rëndësi të përcaktimit të identitetit kombëtar është përdorimi i gjuhës amtare (private, publike dhe zyrtare) dhe arsimimi nacional. Njohjet historike tregojnë se themelimi i shkollave në trojet shqiptare u bë gjatë mesjetës me nismën e urdhrave kishitarë, sidomos të urdhrat dominikan. Një aktivitet i këtyre filloi së pari në Ulqin rreth vitit 1258, në Kotorr më 1266, në Durrës më 1278, në Shkodër më 1345 dhe në Tivar nga gjysma e dytë e shekullit XIV.

Gjuha shqipe, si gjuhë e shkruar, në këtë kohë ende nuk ishte në gjendje t'i bënte ballë shkrimit greqisht, latinisht dhe sllavisht, gjuhë kishtare me rëndësi, të cilat për më tepër kishin mbështetjen e institucioneve të administratës shtetërore. Ajo shërbente si gjuhë e komunikimit të përditshëm si për shtresat popullore, ashtu dhe për fisnikërinë e klerin vendas. Kështu, në shekullin XIV shqipja përdorej në administratën e bashkësisë qytetare të Ulqinit, ku në mbledhjet të Këshillit të Madh ajo ishte gjuha e shërbimit.

Një ndryshim me rëndësi shumë të madhe për historië e kulturës shqiptare shfaqet në gjysmën e parë të shekullit XIV, kur dokumentohet për herë të parë se shqipja, përdorej si gjuhë shkrimi. Ky ishte një hap i rëndësishëm për identitetin nacional shqiptar, sepse me përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë shkrimi, viheshin bazat për zhvillimin e mëtejshëm të saj si gjuhë e kulturës dhe e letërsisë shqipe (Historia e Popullit Shqiptar I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë- Instituti i Historisë, f. 354, Tiranë, 2002).

Institucionet kryesore arsimore që u ngritën në periudhën e sundimit osman në Shqipëri, ishin shkollat e komuniteteve myslimane, me mësim në gjuhë turko-osmane dhe arabe.

Shkollat e komunitetit ortodoks, që funksiononin në Shqipëri qysh nga shekulli XVI-XVII ishin nën mbrojtjen Patrikanës së Stambollit. Mësimi në këto shkolla jepej greqisht, në gjuhën e kishës.

Shkollat katolike ishin nën drejtimin e kishës së Romës dhe kishin si detyrë të përgatitjes në mësim-klerikë. Kur misionarët e Romës vunë re se veprimtaria e tyre në Shqipëri nuk po jepte rezultatet që priteshin, për shkak se zhvillohej latinisht ose italisht dhe jo në gjuhën e popullit. Roma filloi të përdorte edhe gjuhën shqipe në shkollat fetare katolike. Në këto rrethana u hapën disa shkolla të tilla, ku mësohej edhe gjuha shqipe dhe ku shërbenin si tekste mësimore katekizmat e hartuar nga shkrimtarët klerikë si Pjetër Budi. Këto ishin ngritur kryesisht pranë famullive dhe manastireve. Një shkollë e tillë funksiononte në vitet 1628-1675 në Pedhanë dhe po në atë kohë edhe në Blinisht (te dyja në rrethin e Lezhës), si dhe në Kurbin (rrethi i Krutës). Në 1669-1670 funksiononte një shkollë katolike në gjuhën shqipe edhe në Himarë. Në Pedhanë e në Blinisht u krijuan më vonë edhe shkolla më të larta, gjimnaze, ku përdorej gjithashtu gjuha shqipe. Këto shkolla u ngritën nga murgjit françeskanë. Shkolla të mesme shqipe katolike u hapën edhe në Janievë të Kosovës (1671), në Velje të Mirëditës (1699), në qytetin e Shkodrës (1699). Në këto shkolla të mesme nxënësit, që ishin destinuar për t'u bërë klerikë, studionin teologjinë, gjuhët latine e italiane dhe disa prej tyre dërgoheshin për studime më të larta në Itali.

Mësimi i gjuhës shqipe në këto shkolla, ishte në interes të popullsisë vendase, që

i përkrahte ato. Kështu gjimnazi i Blinishtit u ngrit me kërkesën e krerëve të vendit dhe kur në vitin 1648 shkolla e Pëdhanës u rrafshua nga një ekspeditë ndëshkimore osmane, banorët e fshatit e rindëruan atë përsëri.

Në vitin 1622 kisha katolike krijoi institucionin me emrin "De Propaganda Fide", me qendër në Romë. Ky ngriti disa shkolla për përgatitjen e klerikëve shqiptarë, si Kolegji ilirik i Femos (1633), që drejtohej nga misionarët jezuitë, shkolla e Montorinos në Romë, nën drejtimin e misionarëve françeskan e te tjere.

Rrethana më e favorshme për arsimin shqip u krijuan, kur në fronin e papës hipi Klementi XI, me origjinë shqiptare. Me nismën e tij u mblodh më 1703 Koncili i peshkopëve të Shqipërisë, që njihet me emrin "Koncili i Arbërit", i cili vendosi të përhapte letërsinë fetare në gjuhën shqipe. Tetë vjet më vonë, më 1711, në shkollën e Montorinos në Romë u hap katedra e gjuhës shqipe (Historia e Popullit Shqiptar, tomi I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë- Instituti i Historisë, faqe, 704-706, Tiranë, 2002).

Në bazë të dhënave të lartpërmendura, si dhe të njohjeve tjera historike mund të konstatohet se një rol të rëndësishëm në veprimtarin arsimor dhe kulturor në gjuhën shqipe në mesjetë tek shqiptarët e ka luajtur kisha katolike. Ajo pati në dorë përgatitjen e inteligjencës së kohës. Shumica e njerëzëve të kulturës, veçenarisht në shekujt e mesjetës së herët, ishin thuajse pa përjashtim klerikë. Në duarët e tyre ishin filozofia e letërsia, arsimi dhe artet. Si qendra të arsimit dhe të veprimtarisë kulturore-artistike shërbyen manastiret fetare. Në shkollat pranë manastirave, mësohej kursi tradicional mësimor që jepej edhe në shkollat e vendeve perëndimore. Ai përbëhej nga cikli i ulët që përfshinte lëndët letrare (gramatikë, retorikë, didaktikë) dhe cikli i lartë me lëndë shkencore (aritmetikë, geometri, astronomi e muzikë).

Në shekullin XIV e në fillimin e shekullit XV numri i intelektualëve klerikë shqiptarë ishte njëjftë i madh. Ata gjenden të përhapur edhe jashtë Shqipërisë, në shumë qytete dalmatine ku kryenin funksione kancelarësh, mësuesish, famulltarësh e te tjere.

Po ashtu në atë kohë shënohej një rritje e zgjerim në përdorimin e shkrimit dhe në zhvillimin e letërsisë e të arsimit në tokat shqiptare. Megjithatë, që veprat letrare ishin të shkruara në një frymë teologjike, këto prodhime përbëjnë hapat e para të historiografisë në trojet shqiptare, sepse pikërisht një pjesë e këtyre është hartuar nga autorët shqiptarë.

Shkeputjen nga ndikimi kishitar dhe kalimi në historiografinë laike, këtë hap në historinë e kulturës shqiptare, e bënë humanistët shqiptarë në fund të shekullit XV e në fillim të shekullit XVI, por tanimë në kushtet e pushtimit osman të vendit, jashtë Shqipërisë.

Gjatë kohës së sundimit osman në trojet shqiptare shkollat ishin të ndara veç për popullsin myslimane dhe veç për atë të krishterë. Përveç shkollave turke, ishin hapur dhe një numer i madh i shkollave private: greke, serbe, bullgare, austriake e italiane. Në ato shkolla mësimi zhvillohej në gjuhë të huaja, ndërsa gjuha shqipe ishte e përjashtuar nga mësimdhënia, çka rrezikonte që të zhdukej pa nam e pa nishan me kalimin e kohës.

Perandoria Osmane nuk njihje në zotërimet e veta nacionalitetin shqiptar, por vetëm komunitete fetare: myslimanë, ortodoksë dhe latinë (katolikë). Rrjedhimisht edhe shqiptarët ishin grupuar në këtë tri komunitete fetare dhe nuk njiheshin si një njësi nacionale më vete.

Përveç kësaj, komunitetet e tyre fetare ishin të varura nga tri qendra të ndryshme të huaja kishtare e kulturore. Sistemi arsimor i kohës ishte shëndërruar në një mjet të fuqishëm ndikimi politik e kulturor si të sundimit osman, ashtu edhe të shtetëve të tjera.

Një pjesë e atyre shkollave kishin një dimension të propagandave të shteteve të huaja për asimilimin e shqiptarëve. Prandaj rilindësit i trajtonin ato si një pengesë në lëvizjen për çlirimin nacional të popullit shqiptar dhe kërkonin mbydhjen e tyre ose kthimin e tyre në shkolla shqipe.

Ndryshe nga autoritetet osmane që e përkufizonin nacionalitetin mbi bazën e fesë, intelektualët e Rilindjes nacionale shqiptare mendonin se nacionaliteti ishte në radhë të parë gjuha. Në themel të nacionalitetit shqiptar ishte gjuha. Ajo u kishte bërë ballë të gjitha përpjekjeve për asimilim, që nga koha e pushtimit romak. Ajo duhej të ishte njëzëri gjuhë letërsie të shkruar dhe gjuhë arsimit.

Duhet thënë se, deri në mesin e shekullit XIX, librat në shqip ishin shumë të rrallë dhe se nuk kishte normë shkrimi mbi bazën e një alfabeti të veçantë. Tekstet e botura ishin nxjerrë pikësisht për qëllime fetare dhe alfabetet e përdorura ishin grek, por edhe arab. Mungesa e një drejtshkrimi të njëzëri dhe numri i paktë i botimeve në shqip shpjegohen me faktin se, qysh nga koha e pushtimit romak në shekullin e II para lindjes së Krishtit, shqiptarët, ose paraardhësit e tyre ilirët, dardanë apo epirotë nuk kanë qenë kurrë përnjëmend zot të vetes. Po të veçohet mënjëanë episodi i Principatës shqiptare të Gjergj Kastriotit në shekullin XV, ata kanë qenë gjithmonë të sunduar: nga romakët, bizantinët, sllavët dhe osmanët. Natyrisht, as që kanë mundur për t'iu kundërvu fuqive të mëdha. Andaj dhe gjuha administrative ishte një gjuhë e huaj, por edhe shqipja e përjashtuar nga liturgjia. Tek shqiptarët që i ngadalshëm e i vonë ndërgjegjësimi se përbëjnë një nacionalitet. Ai zuri fill nga mesi i shekullit XIX me shenjat e para të një lëvizje kulturore që u quajt Rilindja Nacionale. Lindja e vetëdijes nacionale lidhej me idenë se gjuha shqipe ishte një pasuri, në trashigimi prej të parëve, që ishte e udhës të mbrohej.

Rrahja e mendimeve për një normë shkrimi të shqipes, beteja për arsimin në këtë gjuhë, shpinin në një kërkim identiteti. Ndjesia e shqiptarëve se i përkisnin një popullit shumë të lashtë, u përforcua nëpërmjet përcjelljes së miteve dhe kultit të heronjeve.

Patriotët e Rilindjes nacionale punuan me përkushtim për zhvillimin e arsimit shqiptar. Mirëpo, në atë drejtim krahas pengesave të regjimit osman, i cili ishte përpjekur gjithnjë t'i mbante shqiptarët në errësi dhe në padituri, si dhe faktorëve të jashtëm, ata hasën dhe në pengesa dhe për shkak të përçarjes së shqiptarëve nga pikëpamja fetare.

Karakter i përçarë i fesë në tri besime kryesore: islame, katolike e ortodokse, si dhe i tri shkollave fetare me ndikim financiar dhe programor nga të huajt vuri në rrezik veprimin e bashkuar të shqiptarëve në luftën e tyre për liri. Mu për këtë arsye patriotët e parë nisën të nxinin shqiptarinë mbi të gjitha fetë. Gjatë luftës për pavarësi nga Turqia Pashko Vasa, një patriot dhe poet nacional nga Shkodra, shkruante: "Çoni, o shqiptarë, prej gjumi çoni, /të gjithë si vllazën në një besë shtrëngoni, /edhe mos shikoni kisha e xhamia, /fe e shqyptarit asht shqypria...".

Një nga udhëheqësit e shquar të Rilindjes kombëtare, Sami Frashëri, kishte shkruar më 1899: "Shqiptari është shqipëtar përpara se të jetë mysliman a i kreshtenë. Besa s'e ka ndruarë fare edhe kurrë, se nacionaliteti ashtë përpara besës...".

Një vazhdim të së njëjtës ide, një vjershator popullor thoshte: "Besa juaj sot/ s'është as kishë as xhami / por Nëna Shqipëri ! / Kur të fitojmë lirinë / do të kujdesi për kishën e xhaminë. Nëse kisha ka një këmbanë / njëqind të varni anëmbanë. / Nëse kini në fshat vetëm një xhami / ndëtoni edhe njëzet e tri. / Por feja jonë tani / është Nëna Shqipëri".

Edhe pas fitores së pavarësisë së Shqipërisë, patriotët shqiptar kishin bindjen se e

vetmja zgjidhje për dyzimin e përçarë midis islamizmit dhe krishterimit ishte zëvendësimi i tyre me shqiptarinë. Kështu, Andon Zako Çajupi në librin e tij Mëmdheu, përfshiu në të një poemë për Malin e Tomorit. Në majën e malit ndodhej një faltore, ku shqiptarët e lashtë shkonin të këshilloheshin me orakullin për të ardhmen e tyre. Poeti shkruante: "Baba Tomor, kishë e Shqipërisë, /mal kryelartë, fron i Perëndisë, / tek ti kanë ardhur njerëzia që në lashtësi, /për të mësuar atë që urdhëronte Zoti". Më tej shtonte: "... kombi juaj s'vete mbarë, / se betë u kanë ndarë. / ... të krishterë e myslimanë, / gjithë një perendi kanë; / jini një gjak mor të mjerë, / se një vend kini lerë, / jini gjithë shqiptarë".

Në pajtim me këtë atmosferë mbi-zotëruese elita politike e shtetit shqiptarë të kohës vendosi që shteti të ishte asnjë, pa fe zyrtare, dhe që ushtrimin e lirë të besimit duhet ta gëzonin të gjitha fetë. Ata vunë si fe shqiptarinë, duke i quejtur nëpunësit dhe mësuesit "apostuj" dhe "misionarë". Në tëra aktivitete shoqërore publike, si dhe në fushën e arsimit dhe kulturës shprehej një shqiptari e zjarrtë që kishte për qëllim të eklipsonte dasitë fetare dhe të bashkonte popullin shqiptar.

Shqiptarët kanë pasur një vonesë në zgjimin e ndërgjegjes nacionale shqiptare, e cila ishte kryesisht pasojë e përçarjes fetare: nën sundimin osman, dy të tretat e popullsisë shqiptare ishin kthyer në fenë islame, ndërkohë që një e treta që mbetej ishte edhe ajo e ndarë në të krishterë katolik në Veri dhe ortodoksë të rritit grek, në Jug. Të mbështetur në këtë përçarje autoritetet osmane e mohonin ekzistencën e një nacionaliteti shqiptar. Ata e përkufizonin nacionalitetin në bazë të fesë - parimi i miletit (Studiuesi Serge Metais, Histori e Shqiptarëve- nga Ilirët deri te Pavarësia e Kosovës, f. 16, Tiranë, 2006).

Si pasojë e zgjimit të vonë të vetëdijes nacionale te shqiptarët dhe të mungesës së përkrahësive të tyre jashtë Perandorisë Osmane, Bismarku tha në Kongresin e Berlinit më 1878 se, Shqipëria nuk ishte veçësë një shprehje gjeografike dhe se nuk ekziston kurrëfarë nacionaliteti shqiptar. Dhe jo vetëm Bismarku si kryesues i Kongresit, por asnjë prej fuqive të mëdha nuk i njishin shqiptarë si nacionalitet, e kjo ka qenë fatale për zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare. Sepse si parim i njohjes dhe i formimit të shteteve europiane dhe ballkanike ishte parimi nacional. Shqiptarët me vonesë të madhe bëjnë përpjeke që prej horizonteve politike osmane të dalin në horizonte evropiane. Në lidhje me këtë çështje profesor Rexhep Qosja, ndër të tjerat shprehet: "Në Kongresin e Berlinit përfaqësuesëve shqiptarë nuk u lëjohet të marrin pjesë në cilësi zyrtare në punimet e tij, sepse në Kongresin e Berlinit trojet shqiptare trajtohen zotërime turke", kurse shqiptarët nënshkruan të Turqisë"! Vetëm pse rreth dy të tretat e tij e kishin pranuar fenë myslimane, shpallej kështu popullë i paqenë! Më tutje Qosja shton: "Shqiptarët kanë pësuar dëmtim të rëndë, tragjik, prej politikës së fuqive të Mëdha evropiane... për arsye se dy të tretat e tij i takonin fesë myslimane dhe pse ishin nën pushtimet e një perandorie që këtë fe e kishte përhapur me shtatë dhe zjarr. Në kohën kur për Evropën e krishterë feja dhe kombësia ishin njësh, shqiptarët e gjetur në gjirin e një perandorie, pothuaj, islamike, s'kishin se si të shikoheshin veçse si dikush që nuk i takon Evropës as me fenë, as me etninë, prandaj as me fatin, si dikush që prej Evropës trajtohej i përjashtuari i Evropës!"

(Rexhep Qosja, Studimi: Çështja Shqiptare-Historia dhe politika, faq. 8 dhe 47, Instituti albanologjik, Prishtinë, 1994).

\* **Autori është politikolog, kryeredaktor i revistës për kulturë, shkencë e çështje shoqërore "Malësia" dhe Këshilltar i Avokatit të Popullit në Mal të Zi**

# Një këshillë për prindit: Mos u mundoni të thani detin por mësojuni fëmijëve notin

## Hapja ...

Lekë Imeraj u lind në komunën Lekbibaj, me 03. 09. 1944. Ka studiuar për letërsi dhe filozofi dhe ka mbaruar Akademinë e Rendit. Ka punuar si mësues dhe ushtarak. Në lëmin e krijimtarisë ka shkruar libra të fushës psikofilozofike. Deri tani ka botuar librat: "Tomi mëson, luan dhe vizaton" (libër për fëmijë), "Viktima te pushtetit të verbër", "Të fshehtat e gruas", "Ne nuk jemi më fëmijë", "Konfliktet" dhe "Dhuna". Ka përkthyer nga gjermanishtja librat: "Unë, studente dhe prostitute" (roman) dhe "Tragjedia seksuale e Gjermanisë".

**Të lutem ne qofte se e ke në kompjuter prezantimin e të gjithë librave, siç është paraqit tek libri "Konfliktet" tuaj kaloje tek bashkëbisedimi**

Falënderim për pranimin e bashkëbisedimit ...

Z. Lekë ju falënderoj shumë që krahas angazhimeve të shumta që keni, na dhurat mundësinë që t'ju intervistojmë ...

-Mjeshtri i Madh, Fadil Kraja ka shkruar tek libri juaj "Të fshehtat e gruas".... them se këtë libër duhet ta lexojmë të gjithë, sepse të gjithë jemi aty, jemi brenda tij, duam apo nuk duam, na pëlqen ose jo ... Duke pasur fatin t'i lexoj të gjithë librat tuaj, unë i bashkohem mendimit të Z. Fadil dhe do t'i rekomandoja të gjithëve që ti lexojnë të gjithë librat tuaj. Lexuesi kureshtar mund të pyesë përse duhen lexuar librat tuaj të gjithë? Përgjigja është se; krijimtaria juaj është e lidhur zinxhir, qe po ja shkapëpute një hallkë nuk arrin ta njohësh plotësisht.

**Z. Lekë e keni filluar me një libër për fëmijë, keni vazhduar për adoleshencën dhe fazat që e shoqërojnë këtë moshë. Keni sjell me mjaft delikatesë, tragjedinë dhe të fshehtat e gruas .... dhe jemi sot, pas promovimit mjaft të suksesshëm të librit "Dhuna". A mund të dimë se si ju e keni planifikuar krijimtarinë tuaj, që ajo t'i shërbej sa më mirë njeriut, familjes dhe shoqërisë?**

Unë vazhdoj të punoj. Jam shkëputur në moshë fëmijore nga gjiri i familjes. Më ka munguar prehri i nënës dhe dora e babës. E kam ndërre shumë këtë mungesë. Nga vendi i punës që kam pasur, kam parë shumë njerëz që vuanin dhe si vuanin. Kryesisht këta të dy faktorë, por edhe të tjerë, tek unë, brenda meje, zhvilluan moton: Tek njeriu, me njeriun, për njeriun. Unë po mundohem të eci në këtë rrugë. Dëshiroj të jem gjithnjë pranë njerëzve. Nuk kam ndërmend të ndalem, me shkrime dhe përkthime. Shumë njerëz ose pjesa më e madhe e tyre gabojnë nga padia. Injoranca është djepi i dhunës.

**Në një nga takimet e para që kemi pasur, nga ju kam mësuar një shprehje shumë të vlershme; "Mos u mundoni të thani detin, por mësojuni fëmijëve notin" ... Duke lexuar librat tuaj e kam takuar këtë thënie të zbatuar nga ana juaj. Ju**

**me pendën tuaj po sensibilizoni familjen dhe shoqërinë se, cila është rruga që duhet të ndiqet që familja dhe shoqëria të jenë të shëndosha. Në qendër keni vendosur njeriun. Pse?**

Roza, është për të ardhur keq që shumë njerëz, ngaqë nuk dinë ndryshe, mendojnë se ne jemi një popull i mbrapsht, i ndëshkuar gjenetikisht. Kjo nuk është e vërtetë. Gjenetikisht ne jemi një lloj si dhe gjithë popujt e tjerë të Evropës dhe botës; si popujt më të përparuar, si suedezët, norvegjezët, gjermanët, e te tjere. 99 përqind e geneve janë të njëjlojta për gjithë njerëzimin, vetëm 1 përqind është ajo që na bën të ndryshëm nga njeri-tjetri. Por, nëse në vendet e zhvillu-

pasigurte. Ne jemi një popull që vuajmë nga ndjenja e pasigurisë dhe frikës. Në të gjithë librat e mi, unë mundohem që t'i çliroj njerëzit nga frika. Kjo është arsyeja që unë në qendër të librave të mi kam njeriun. Një popull mund të përparojë vetëm atëherë kur individi nuk do të ketë më frikë nga frika. Ne dhunojmë se vuajmë nga frika. Ne vrasim se vuajmë nga frika. Vetëm frikacaku vret! Trimi nuk vret kurrë.

**Po të shikosh me vëmendje, në librat tuaj një vend të veçantë, zë ana e brendshme e njeriut, a mund të na shpjegojnë pse ju këmbëngulni në këtë aspekt? Çfarë do të thotë për ju brendësia e njeriut?**



ara, genet kriminale "dremisin", për faktin se atje njeriu është i sigurt dhe nuk ka frikë, pasi nuk ndjehet kurrë i rrezikuar, tek ne, genet kriminale janë vazhdimisht në alarm dhe në shkallën më të lartë të gatishmërisë. Ne nuk kemi qenë kurrë të sigurt dhe vazhdojmë të jemi të

Sipas psikologjisë, njeriu mendon atë që ndjen dhe sillet ashtu siç mendon. Pra mekanizmi i ndjenjave të njeriut, është ai që e "timonon" atë në jetën sociale. Dhe ky mekanizëm nuk është i lindur. Ai formohet tek njeriu. Dhe ky formim fillon që në barkun e nënës. Një nënë e dhunuar gjatë periudhës së shtatzënisë, është fare e mundshme që të lindë një "kriminel". Një mjedis brutal, i egër dhe i dhunshëm, dëmton rëndë mekanizmin e ndjenjave tek njeriu. Paqja dhe harmonia me botën nisë me paqen dhe harmoninë me vetveten. Një shpirt i helmuar nuk mund të sheqerosë mjedisin. Ai vetëm sa e helmon atë, gjithnjë e më shumë. Unë kam shumë respekt për besimtarët e vërtetë por, ku janë ata? Shikoj njerëz që shkojnë në kishë, madje rregullisht por, gjithashtu shikoj se, tek ata nuk ndryshon asgjë. Shumë nga ata i luten Zotit që t'i vrasë armiqtë e tyre, pra, duan që edhe Zotin ta bëjnë bashkëpunëtor në krim. Nuk kam dëgjuar kurrë një "besimtar" që t'i lutet Zotit që ta falë mëkatin e vet. Ashtu siç bëri Krishti. Dhe e gjithë kjo vjen se ata janë të helmuar nga brenda. Ne vuajmë nga ndjenjat negative si; urrejtja, smira, hakmarrja, gjakmarrja, xhelozia e te tjera.


Duket sikur një pjesë e madhe e popullsisë është plotësisht nën pushtetin e tyre. Urrëjtja absolute është vetëvrasje me porosi. Këto e helmojnë shpirtin e njeriut dhe për pasojë mjedisin ku ai jeton, prandaj unë i kushtoj shumë vëmendje pastrimit të shpirtit nga ky "helm" dhe ndërtimit të paqes me vetveten. Duket sikur në kulturën tonë, tjetri mendohet *mik* ose *armik*. E mesmja midis tyre, *tolerancë me cilindo*, nuk ekziston. Dhe kjo nuk është e lindur, është e mësuar dhe çdo gjë që nuk është e lindur, por është e mësuar, mund të çmësohet. Njeriu duhet dhe mund të mësojë të falë, por kjo fillon me pranimin dhe faljen e vetvetes.

**Femra, është sjellë për lexuesin nga ana juaj në mënyrë perfekt. Përse kjo këmbëngulje për ta zbuluar femrën për vetën e saj, por dhe për të tjerët?**

Shumë njerëz e mendojnë respektin ndaj femrës çështje kulture dhe kaq. Kjo qëndron, por është diçka tjetër shumë më e madhe se kaq. Femra është "gjysmëhëna" tjetër e njerëzimit. Nëse do t'i shikojmë detyrat biologjike të femrës, ato janë shumë më të rëndësishme dhe më të vështira se të meshkujve. Lindja, të ushqyerit, rritja dhe edukimi i pasardhësve janë detyrat biologjike të femrës. A nuk janë mjaft këto? Por nuk janë vetëm këto. Ka edhe shumë fusha dhe veprimtari të tjera ku femra është pranë dhe në kraht të burrit. Niveli i civilizimit të një populli, vendoset në prehrin e nënave. Aty ku dhuhet dhe poshtërohet femra, mbillet barbaria dhe korret vdekja. Burrat e zbulojnë botën, gratë e zhvillojnë njerëzimin.

**Në një nga librat kam shkëputur këtë frazë: "... nuk ...nuk gjeta rrugë tjetër"- këtu takojmë njeriun në udhëkryqe që ditët e sotme po ja japin pa mëshirë ... Si njohës i mirë i këtij realiteti të hidhur, cili është mesazhi juaj për familjen dhe shoqërinë, pjesë e të cilave është ky njeri?**

Kjo është tek libri: "Unë, student dhe prostitute". Në kapitalizëm njeriu nuk ka shumë shanse për të jetuar. Unë e kam deklaruar në librat e mi se, *kapitalisto-demokracia* është një mashtrim që po i bëhet njerëzimit. Aristoteli ka thënë se: "Oligarki, hierarki dhe demokraci nuk duhet të ketë kurrë. Demokraci, jo dhe jo". Duhet "mësuar" noti mirë dhe luftuar frika. Nuk e thajmë dot detin. Në këtë sistem na duhet të jetojmë. Secili duhet të mendojë dhe të përpiqet në mënyrën e vet për të jetuar, të paktën për të mbijetuar. Ajo që unë do t'u këshilloja bashkëkombësve të mi është: Mjaft me moralin e pamoralshëm, mjaft me fanatizmin dhe traditat e ngujimit, mjaft me urrejtjen, hakmarrjen dhe gjakmarrjen! Në kapitalizëm gjithkush duhet të ndërtojë moralin e vet, atë lloj morali që i përshtatet më shumë dhe e favorizon në jetën e vet personale. Një gjë duhet pasur mirë parasysh: Njeriu duhet ta shtrijë grushtin sa të dojë, por jo më larg se deri aty ku fillon hunda e tjetrit. Duhet njohur dhe respektuar



# KU JENI, LEKË DUAGJININ UA VRANË!



Nga **Prele Milani**

Pa praninë e opozitës së arratisur në mënyrë dinake dhe burracake Parlamenti i frikshëm anti Berishë i 23 qershorit në emër të ashtuquajturave reforma të mëdha historike integruese, miratoi Ndarjen e re administrative territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Parlamenti i frikshëm anti Berishë më një vetësiguri absolute pavarësisht rebelimit të ca zërave kapriços (thjeshtë për interesa personale) brenda shumicës, votoj unanimisht duke treguar solidaritetin e pa lëkundur rreth vijës së drejtë parimore të Partisë dhe udhëheqësit të saj "syshqiponjë"

Dje u hollën parimet e një konfigurimi të ri administrativ që siç trumbetohet do të sjellë urbanizimin, modernizimin dhe decentralizimin pushteti vendor sipas parimeve evropiane, d.m.th: "Lum si ne kur të pjelli lopa se do fryhemi duke ngrenë përshesha me tamel".

Parlamenti i Shqipërisë së bashku me shumë gema të thatë që nuk kishin vend në trupin e shëndoshtë të një peme administrative dërmoi me forcën e kartonit edhe shumë degë të njoma madje nga më të harlisurat sistemit eshtërorë të shqiptarizmit. Kush ka sy me pa duket qartë se ustallarët e Reformës janë treguar dorërendë mbi Gegërinë, duke shartuar një padrejtësi të re politike, pa-drejtësi që arrin kulmin me vrasjen politike që

bënë Dukagjinit duke e zbur përfundimisht nga harta politike e një krahinë qindra vjeçare qind karas shqiptare. Atë që nuk e beri shpata dhe ushta e otomanit për shekuj e beri brenda një seance Parlamenti ynë "rilindës". Prazmarja më krenare e qëndresës e maleve të Kanutit, përfundoj në grumbullin e hekurishteve të skrapit diku në periferi të Shkodrës.

Ka 24 vite që flitet e sterilitetet me shumë të drejtë për dëmshpërblimin dhe integrimin e të persekutuarëve politik nga Diktatura komuniste, dhe madje fare pak eshtë bërë për ketë shtrese. Kurrë nuk eshtë fol tash 100 vjet as një fjalë për Dukagjinin si treva më e persekutuar, më vuajtur e mjeruar, por edhe lirë Shqipërisë natyrale nga okupacioni ogurzi otomanist 500 vjeçare. As një zonë tjetër nuk ka qenë më persekutuar, nga diktatura Zogiste dhe Enveriste dhe aq e diskriminuar në mënyrë sistematike nga gjitha qeveritë qindvjeçare të shtetit tonë minor. Për hir të gjitha sakrificave martire, shekullore, autentizmit të historik. Për hir të vizionit të urbanizimit të Alpeve tona madhështore dhe krijimit e lidhjeve organike nder shqiptare Adriatik - Mali Zi-Aple-Kosovë me pjesën tjetër të Evropës edhe sikur Dukagjini të ishte komplet shkretëtirë duhej të krijohet një oaz i ri urban në qendër të alpeve tona. Qofsha i gabuar, por sipas optikës time kjo reformë, varrosë përfundimisht një korridor të tillë, së bashku filozofinë e një zhvillimi ndërballkanik, ndërsa varrosja e themeleve të kështjellës emblematike të dukagjinase eshtë vijim i linjës politike të pa ndërpre otomaniste-Zogistopuniste e sundimtarëve të Tiranës. U

përmbys përfundimi një nga tërvesat më bujare të trevave ilire. Dukagjini i nëntë flamurëve të pa përlyer dhe i kryqeve të pa thyer që nga sot e në vijim nuk do të mblidhet kurrë më një tërvesë politike. Nikaj e Mërturi do vijojnë të mbetën një bisht i përbuzur i Tropojës. Shllaku, Temali e Toplana kanë përfunduar si "Musa pas daive" në ish kantierin e Hidrocentralit Mao Ce Dun të Vaudejsit. Shala, Shoshi dhe Pulti ju bashkëngjitën si rrodhe pas bythe një buallice që brirët i ka në Jezercë bishtin në Velipojë dhe cicat do mjelën në Shkodër. Dukagjini dje u vra politikisht. Qe plagosë rëndë që vitin 1948 dhe gjithë politika e deri sotme kanë çuar ketë krahinë në prag të rrënim-it fatal. Për fatin e keq jo pak dukagjinat sot pajtohen me ketë realitet. Madje janë të kënaqur me statusin e plebeut bark fryrë që shkojnë si delet e humbura pas trokes së një kopeje tjetër. Nuk u bënë përshtypje, shkarja në llumin e lympenit të qytetit, vazhdojnë avazin e arkaizmave e armiçësive të vjetra e te reja, vuajnë nga gripi i rëndë inferioritetit, duke u bashkangjitur korit të cinikëve dhe përbuzësve kundër vetvetes dhe Dukagjinit tyre. Dukagjinin dje e vrane. "Dreq Aga" i politikës i hoqi gisht, kurse pushkën ja mbushëm ne me fishekët tanë. Qeverisja lokale e shëmtuar 24 vjeçare, rrënimi i gjithçkaje publike, braktisja masive. Mos vetë-përfaqësimi politik, bënë që tata i vjetër të vdesë së shkreti i braktisur nga gjithkush. Babilonia, Kartagjena, Sparta, Roma, Kalifati Arab e dhjetëra e qindra qytetëtime, Perandori, politikisht kanë vdekur, por historikisht nuk harrohen kurrë. Dukagjini vdiq politikisht, por jo

si emër i për-vetshëm historik. Historinë e Dukagjinit e kanë shkruar leket që prehen në varre dhe ne këndojmë për ta me çifteli. Dukagjin vdiq se lekët e vërtetë nuk gjenden askund në politikë. Mua më vjen turp si bashkëkohës që nuk luftuam dhe nuk e shpëtuam Dukagjinin nga vrasja politike. Dukagjini ka mësues të shquar, ushtarak te talentuar, prokuror e avokat me integritet, agronom e mjek të talentuar, inxhinier të devotshëm, artist, krijues e sportist të mirënjohur, ekonomist dhe menaxher të kompetent.

Me një fjalë, Dukagjini ka jo pak nëpunës profesionist të lidhur ngushtë pas një rroge, ndërkohë që fushën politike ka një inteligjencë të tredhur, e cila e la Dukagjinin të vdesë për së shkreti. Leket në varre dhe brezat që po rritën meritonin të kishin emblemën e tyre. Në që e patëm ketë emblemë dhe nuk e ruajtëm do na presë gjykatorka e historisë! Zërat të mblidhemi, të dalim në rrugë, të kërkojmë referendum apo të përmbysim qeverinë, ngjasojnë me tentativën e plakës, e cila pasi .... i vuri llozin derës. Mos qenia e Dukagjinit si njësi administrative eshtë humbje poshtëruese politike. Se pari, Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" dhe në se ka intelektual me integritet duhet brenda 6 muajsh të bëjnë regjistrimin e gjithë popullsisë së Dukagjinit kudo që gjendet (pra një shumë të përpiktë dukagjinat), pastaj të organizohet një Besëlidhje mbarë rajonale që në zgjedhjet e ardhshme lokale, të dilet më një listë kandidatësh, jashtë bastioneve për te siguruar vetë përfaqësim maksimal si as një herë më parë dhe për të vënë vend nderin e nëpërkëmbur nga demonët (PS-PD).

mirë kufiri midis: E imja dhe e jotja, e jona dhe e atyre. Ndryshe do të mbytemi në konflikte dhe do të gjakosemi nga dhuna, siç po ndodh tani.

**Falë jetës që bëni, ju njihni shumë mirë realitetin lindor dhe perëndimor. Çfarë i bashkon dhe çfarë i ndan këto dy realitete?**

Unë jam njëri nga ata që po përjetoj tri sisteme shoqërore: Diktaturën komuniste; demokracinë perëndimore dhe lumen-komunizmin tonë këto 23 vjet. Njerëzit perëndimorë, tashmë janë mësuar me shtetin e së drejtës, me shtetin ligjor, me respektimin dhe zbatimin e ligjit. Kanë krijuar vizion të qartë mbi atë që duhet të bëjnë dhe nuk duhet të bëjnë, si duhet të sillen dhe si nuk duhet të sillen, kur duhet thënë PO dhe kur duhet thënë JO. Gjermania, p.sh. eshtë një shtet që drejtohet me tabela. Meqenëse përmenda Gjermaninë, dua të theksoj se ai popull zotëron në perfeksion tri cilësitë bazë që i duhen çdo nocióni për të arritur aty ku eshtë Gjermania sot, në majën e botës: **Patriotizmi, disiplina dhe demokracia.** Gjithkush ka ndërtuar moralin e vet dhe askush nuk i përzihet tjetrit në punët e veta. Gjithkund dhe mbi gjithçka eshtë ligji. Tek ne eshtë e kundërta. Me rënien e komunizmit, shteti e humbi kontrollin mbi njerëzit dhe njerëzit kaluan në anarki. Ai civilizim i brishtë i qyteteve tona, u thermua brenda ditës nga barbaria

e prapamalasve, jug-veri, lindje-perëndim, të cilët morën shtetin dhe pushtetin. Qeverisjen e vendit e morën në dorë lumen-komunistët, të cilët për të siguruar jetëgjatësinë e tyre në pushtet, e mbushën administratën shtetërore me njerëz kriminel dhe antisocialë. Kjo vihet re kudo sot tek ne. Prandaj ne kemi kaq shumë konflikte dhe dhunë, vrasje dhe gjakderdhje. Ja, ky eshtë ndryshimi.

**Kam qenë e pranishme në promovimin e librit "Dhuna" që u zhvillua me datën 18 tetor në Bibliotekën "Marin Barleti" në Shkodër dhe për herë të parë në promovimin e një libri kam takuar përfaqësues të shumë shoqatave, që veprojnë në Shkodër. Ja vlen të përmend se, pothuajse të gjitha këto shoqata nëpërmjet një përfaqësuesi e morën fjalën dhe dhanë mendimet e tyre në lidhje me krijimtarinë tuaj. U propozua që librat tuaj të përfshihen në tekstet shkollorë. Si e keni ndjerë vetën përpara këtyre kërkesave dhe sa i ndjeni të realizueshme këto kërkesa?**

Unë kam bërë disa paraqitje librash këtu në Shkodër. E kam dashur shumë Shkodrën dhe sigurisht që do ta dua gjithmonë. Unë nuk kam ardhur në Shkodër që të marr diçka nga ky qytet, por që t'i jap atë që kam mundësi. Në të gjitha rastet jam ndjerë shumë mire, por në rastin që përmendet ju, më mire se asnjëherë tjetër. Dhe kjo për faktin se, përfaqësues

të shoqatave të ndryshme, diskutuan për librin tim duke e lidhur atë me punët e tyre. Kjo më dha të kuptoj se ata njerëz, megjithëse në kushte shumë të vështira politike, sociale, morale dhe materiale, po mendojnë seriozisht për t'i dhënë sa më shumë shoqërisë. Ky eshtë një tregues i mire. Unë nuk kam të drejtë të mendoj se librat e mi nuk do të vlerësohen ashtu siç propozuan ata / ato, pra për t'u përfshirë në tekstet shkollorë. E vështirë më duket. Këtu tek ne akoma gjithçka e drejton politika dhe politika e jonë do shumë kohë që të guxojë ta delegojë pushtetin tek specialistët. Por, edhe nëse po, ku janë specialistët? Qeverisja e vendit për 23 vjet nga lumen-komunistët ka shkatërruar dhe degjeneruar administratën dhe njeriun. Ne nuk e dimë se kush janë dhe të kujt janë "specialistët" e administratës të sotme shtetërore.

**Kam thënë në fillim të bashkëbisedimit se krijimtarinë tuaj, ja keni sjellë lexuesit në formën e një zinxhiri, i cili për mendimin tim duhet të ketë edhe shumë e shumë pjesë te tjera te këtij zinxhiri. Pas librave "Konfliktet" dhe "Dhuna" cili eshtë libri i radhës?**

Unë, në krijimtarinë time, gjithnjë do të eci me moton: Tek njeriu, me njeriun, për njeriun. Kam përkthyer një libër dhe besoj se këtë muaj del nga botimi, me temë nga Iraku, kam një libër tjetër në dorë të një filozofi egjiptian ku flet për

rrezikun fashist në islamizëm, dhe kështu me radhë.

**Duke parë kërkesën e ditëve të fundit për ti blerë librat tuaj, ku mund të na drejtoni ne si lexues për t'i blerë ato?**

Librat e mi, në Shkodër i gjeni tek libraritë; Ora dhe Gogaj. Janë shpërndarë edhe në rrethet e tjera të vendit ...

**I përballur tashmë me një lexues i cili ka dëshirë ta ketë sa më shpejt në dorë librin tënd, cili eshtë mesazhi, të cilin do t'i përcjellësh lexuesit?**

Mesazhi im për të gjithë lexuesit eshtë: Leximi dëmton injorancën. Që njeriu të bëhet njeri, duhet të mundohet sa më shumë që ta njohë të vërtetën. Dhe e vërteta gjendet në libra. Në rrugë dhe vetëm nga rruga, mësohet krimi, ligësia.

**Z. Lek ju falënderoj përsëri për kohën që na dhuroat, dhe duke ju uruar që sa më shpejt të takohemi në promovimin e radhës. Falënderimi më i madh vjen nga ana e lexuesve për punën e vlershme që po bëni në shërbim të jetës, e cila duhet të njihet dhe t'i shërbehet njeriut, familjes dhe shoqërisë, e pastruar nga veset dhe e pasuruar me virtytet.**

Faleminderit ju, Roza dhe mirënjohje e respekt për Shoqatën "Atdhetare-Dukagjini"! Respekt për kryetarin e saj, z. Ndue Sanaj, me të cilin kam pasur, kam dhe me siguri do të kem një bashkëpunim shumë të frytshëm!

**Bashkëbisedoi Roza Pjetri**

# Muzika qytetare shkodrane 2014

Në jetën e përditshme të qytetit të Shkodrës, kënga popullore shkodrane është gjithmonë e pranishme, si një ushqim shpirtëror e frymëzues, sepse kënga dhe humori janë pjesë e pandashme e banorëve të këtij qyteti.

Organizohen çdo vit koncerte, spektakle, sofa me këngë dhe humor, por të gjitha në performancat e tyre kanë një bazë të vjetër tradicionale që në kulturën shpirtërore njihet si ahengu shkodran.

"Ahengu Shkodran" gjithmonë spontan, që në fillimet e tij, kur djem dhe burra të dashuruar pas muzikës, zejtarë, çirakë, por edhe të shkolluar mblidheshin pas punës, krijonin, kompozonin, interpretonin këngë që lindnin nga shpirti i tyre prej artisti dhe që si një lajm i mirë bëheshin përnjëherë pronë e kulturës së qytetit, duke u interpretuar jo në skena madhështore, por në oborre dasmash, në çardaqe gëzimesh familjare, e pse jo edhe në lokalet luksoze të kohës.

Për ta mbajtur të gjallë këtë traditë, për të mbajtur në formë interpretuesit e vjetër të tij dhe për të sjellë zëra të rinj që e çojnë atë më tej, Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" tanimë hodhi hapat e parë për të krijuar edhe ajo vetë një traditë, që tradita e vjetër të mbetet e gjallë, autentike, por edhe e freskuar me interpretues të rinj që janë pikërisht ata sot përfaqësues të këtij burimi të pashtershëm.

Pas suksesit në audicionin e parë, këtë vit Qendra Kulturore "Pjetër Gaci", për të cilën kam shkruar edhe vjet, mund të themi me krenari se ka vënë edhe një gur të skalitur në mbajtjen gjallë të kësaj tradite mbi 150 vjeçare.

Organizatorët jo më kot zgjedhën oborrin emblemantik të një shtëpie të moçme shkodrane, shtëpia ku ka lindur patrioti Oso Kuka, për ta kthyer në një skenë interpretimi tradicional, e cila që në pamjen e parë të krijonte idenë se po përjetoje këtë aheng si 100 vjet më parë.

Këta imazhe, si në një pikturë, i bënte më të pranishme rekuizita e kërkuar me fanatizëm për veshjen e këngëtarëve, valltarëve dhe formacioneve muzikore.

Dekori nuk kishte nevojë për dorën e një specialisti, pasi në sfond ngrihej madhështore një shtëpi e vjetër, me pullaze e çardak, me pus e avulli, me lule e kall-drëm, e restauruar me profesionalizëm për të ruajtur identitetin e saj.

Ahengu Shkodran pushtoi në këtë mbrëmje këtë oborr shkodran, duke rikthyer traditën e bukur të këtij qyteti të shquar të artit dhe të kulturës, duke përformuar live disa nga kryeveprat e kësaj tradite.

Ky oborr ishte mbushur si rrallë herë, siç mbushet një bahçe me lule të bukura në pranverë. E veçantë dhe pozitive ishte se përveç dashamirësve të moshuar të këtyre këngëve, freski i jepte audiencës moshë e re e spektatorëve, djem e vajza shkodrane që shpesh pa të drejtë "akuzohen" se rëndin pas muzikës moderne dhe harrojnë se qyteti i tyre ka këngë shumë të bukura.

Programin e prezantoi moderatoria Gentiana Dani dhe që në prezantimin e

saj të parë u përcollën emocione që spektatorët e pranishëm kishin kohë pa i shijuar. Ishin këto vlera të interpretuara live dhe me mjeshtri me instrumenta karakteristike popullore, me zëra të mrekulueshëm të artistëve shkodranë e kombinuar me veshjet tradicionale të qytetit.

Koncerti filloi me një potpuri dasme shkodrane të interpretuar nga grupi i këngëtarëve të Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci", duke vazhduar me dy interpretime të tjera, dy këngë perla të njerit nga ahengxhinjtë e shquar shkodran të shekullit të kaluar, Hasan Preza, këngë që u shoqëruan gjatë interpretimit edhe nga kori që krijuan spektatorët e pranishëm.

Çfarë vlere do të kishte nëse këtë pasuri nuk ja transmetojmë brezit të ri. Muzikanti shkodran Gjon Kujxhija, i cili vdiq tragjikisht në moshë të re, ka lënë një pasuri të rrallë «Vallet kombëtare»

Pjetër Gaci, Mark Kaftalli, Nazmi Lishi, Tonin Daia, Shefqet Kruja etj.

Kështu ky spektakël vijoi me një këngëtare që me të drejtë e cilësojnë "Zonja e këngës shkodrane", e njohur në të gjitha trevat shqiptare, Mukades Çanga, e cila erdhi me një këngë të krijuar nga Alush Beqari titulluar "Moj e vogël si flori", duke ngritur peshë spektatorët, që të ngritur në këmbë e shoqëruan me zë dhe duartrokite interpretimin e saj.

Në këtë atmosferë emocionuese spektakli vijoi me këngëtarin që me plot gojë mund ta quajmë "Ashik i ahengut". Skena për atë kanë qenë dhe janë ambjentet e shqyrit, gëzimet familjare, fejesat e martesat. Nuk lodhet kurr "tuj ba aheng" Agim Molla, i cili erdhi me dy këngë: "Mori dallndyshë" të Kol Gurashit dhe "U thasha si thahet fiku".

Siç thonë shkodranë "Ambëlsina në

Për t'i dhënë vlerat tradicionale këtij eventit kaq të dashur e të bukur, u angazhuan me një pasion shumë të madh edhe orkestra e përbërë nga: Anton Kaftalli-vjolinë, Agron Rexha-klarinetë, Indrit Kodralia-klarinetë, Dritan Mlika-kitarrë, Fitim Tuzi-kontrabas, Fatmir Mesi-dajre, drejtues orkestre-fizarmonikë Andi Unaza.

Kostumografi-Angje Mraja, Koreograf-Aldo Nika, Udhëheqës artistik-Bardhyl Hysa. Drejtues organizativ-Sidrit Lohja.

Organizatorët e këtij aktiviteti që vjen për të dytin vit radhasi, thanë se synimi është që të ruhet kjo traditë e bukur dhe të pasurohet më tej për t'ja çuar brezave të rinj të pastër dhe origjinale këtë muzikë.

Drejtuesi artistik i këtij evenimenti, njëkohësisht edhe shefi i muzikës i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" Bardhyl Hysa



të ceremonialit të dasmës shkodrane dhe ndër të tjera ka thënë: «Çdo plak që vdes, merr me vete një visar kombëtar», por për ta mbajtur përsëri të gjallë dhe pronë të qytetit këtë visar, janë talentët e rinj që mendojnë për te.

Gjallëria dhe freskia e përformuar nga Xhuli Pjetraj, Ruzhdi Çeka, Arben Jubani dhe grupi, ishin një aromë e këndshme dhe e freskët në këtë oborr tradicional shkodranë të kthyer në një skenë madhështore.

Duhet të evidentojmë se shkodranët, përfaqësuesit e muzikës qytetare shkodrane në të kaluarën edhe sot mbi traditën e këngës popullore të ahengut dhe asaj folklorike, kanë krijuar dhe krijojnë edhe këngë të reja, të cilat për nga format dhe karakteristikat bëhen pjesë e kësaj pasurie të madhe. Pa dyshim duhet të përmendim krijimtarinë e të mëdhenjëve Ramadan Sokoli, Prenkë Jakova,

fund" u shpreh moderatorja e këtij spektakli Gentiana Dani, e cila prezantoi këngëtarin shkodran "24 karatsh", Bujar Qamili që tanimë si mjeshtrë i madh i takon gjithë botës shqiptare. Bujari nuk i ndahet grupit të Shkodrës, vendlindjes së tij, emocioneve të ahengut shkodran në ambiente të ngushta, por edhe në evente të mëdha që të rëndësishme siç ishte kjo natë. Ai u paraqiti me dy këngë mjaft të dashura e të njohura që këndohen në çdo ambient: "Mbeta gjithë ditën hijeve" krijim i Leonard Dedës dhe "S'ka ma t'bukur se pranvera" krijim i Rud Gurashit dhe përformoi me këngëtarin e mirënjohur Klodiana Brahimi.

Me pjesëmarrjen e këngëtarëve të njohur të muzikës popullore qytetare, përmby 60 minuta publiku i pranishëm shijoi disa nga kryeveprat e kësaj krijimtarie, tashmë të shpallur trashëgemi shpirtërore kombëtare.

ndër të tjera na tha: "Nuk duhet ta kujtojmë vetëm një ditë në vit këtë vlerë, por ajo duhet të promovohet vazhdimisht edhe në ambiente të tjera, në shkolla sidomos, sepse qëllimi është që mundësisht kjo vlerë e trashëguar mos të mbetet nëpër ambientet e mbyllura, nëpër libra e sirtarë, por ajo të përçohet edhe në brezin e ri, përmes këtyre aktiviteteve".

Për këtë aktivitet kaq emocionues, por edhe të rëndësishëm të qytetit të Shkodrës, do të prononcoheshin edhe përfaqësues të shquar të jetës kulturore e artistike të tij.

Shkrimtari i shquar prof. Fadil Kraja me shumë përmallim u shpreh: "Koncerti "Ahengu Shkodran" po bëhet një traditë e bukur. Edhe sivjet u kënaqem dhe u përmalluam me këngën shkodrane që nuk vdes kurrë.

Sa mirë do të ishte që në rreshtat e parë të sallës të shih-

# BERATI - QYTET I 1001 MREKULLIVE!

Nga Beqir M. Cikaqi  
Treviso (Itali)

Ka dy ide për emrin të sotshëm të Beratit: Legjenda ilire thotë: bir e at kanë filluar ta ndërtojnë kalanë për tu mbrojtur...Bullgarët kur e kanë pushtuar këtë qytet ia vunë emrin Qyteti i Bardhë - Beratit i sotëm...

Përndryshe emri i qytetit iu ka ndërruar disa herë nëpër shekuj. Kur kanë jetuar orestët-fis i pellazgëve, është quajtur Orestiada. Antipatrea në vitet 300 P.Kr. Romakët kur e kanë pushtuar e kanë quajtur Albanorum Oppidum (Fortesa e Arbërve). Perandoria Bizantine, ia vuri emrin në Pulheriopolis (Qyteti i bukur). Ndërsa, Bullgarët në Belgrad (Qyteti i Bardhë)...

Një proverb popullor thotë, edhe në raste pikëllimi: "U bë mirë që ndodhi kjo ngjarje, e u takuam...! Unë do shprehem se SEMINARI I 10-të MBARËKOMBËTAR me mësuesit e Mësimin Plotësues në gjuhën shqipe në diasporë, që këtë vit u mbajt në Berat, ishte arsyeja e mire, që u njohëm me qytetin e bukur të Beratit, si me njerëzit, traditën, kulturën, historinë

e lavdishme me të kaluarën e begatshme, me pozitën gjeografike e pamjen karakteristike...të këtij vendbanimi pellazgo-iliro-shqiptar. Normalisht kanë mbetur edhe shumë të tjera pa i kuptuar e vëzhguar. Të gjitha këto veçori e karakteristika natyrore e njerëzore i japin Beratit epitetin e qytetit të 1001 mrekullive!

Në orët e para të pasdites së marte aritëm në Berat. Vendtakimi i parë i mësuesve që vinim nga Prishtina dhe atyre nga Tirana ishte Hotel TOMORI, aty çdo ditë drekonim edhe darkonim se bashku. Meqenëse kapaciteti i hotelit për shtretër ishte i kufizuar, na shpërndan në disa hotele ma të vegjël, p.sh mua me mikun tim Ragip Taçi që shoqëroheshim vazhdimisht, patëm fatin të vendosemi te Hotel OSUMI në Lagjen Mangalem. Kur hyra në hotel që të akomodohemi, nuk me ra në sy pllakati i emrit të rrugës, por kur dola për të shkuar në seancën e parë plenare, nga kureshtja se si quhet rruga, e vërejtja se mbante emrin KOSTAQ STEFA, menjëherë më përshkuan emocionet, sepse këtë emër e kisha dëgjuar qysh në Itali. Ishte emri i martirit të demokracisë, i persekutuar nga regjimi komunist në vi-

tin 1948. Vajzën e Kostaqit, Vitore Stefa Leka, një aktiviste e devotshme e migracionit shqiptar në Itali, e kam mike dhe m'i kishte rrëfyer gjithë mizorit e sistemit ndaj familjes Stefa. U interesova se a jeton dikush aty, por morra përgjigjen se janë në Itali të gjithë. Shtëpia ku ishte pllakati ishte e familjes së Vitores...

Lagja e Mangalemit, ka një pamje karakteristike të shtëpive për shkak të pjerrësisë që ka terreni, shtëpitë janë të ndërtuar njëra mbi(pas) tjetrën, nga larg duken se dritaret e shtëpive janë njëra mbi tjetrën, nga ky konstruksion i dritareve në Lagjen e Mangalemit, Berati njihet si Qyteti i një mbi një dritareve, që ne disa raste devijohet kjo thënie në Qyteti i njëmijë e një dritareve!..

Para se te filloje seanca e Parë plenare, në qendrën kulturore "Margarita Tutulani" na organizuan një mirëseardhje me një program artistik nga fëmijët e shkollave, këngëtar dhe instrumentalist nga Berati.

Ndërsa në fjalën përshëndetëse kryetari i bashkisë së Beratit, z. Fadil Nasufi përveç mirëseardhjes na njoftoi shkurtimisht për Beratin, i cili ndër të tjera po-

tenco:

"Berati është një krenari për Shqipërinë. Ka një histori 2400 vjeçare, unë dhe banorët e Beratit gjithmonë i ftojmë me fjalët: "Mirë se vini në Berat", "Ejani në Berat". Berati flet vetë...Qyteti ynë shfaqet si një monument i pakrahasueshme i bashkekzistencës, duke na dhënë prova autentike dhe një seri të vërtetash që mbrojnë e ndriçojnë racën shqiptare, gjenezën tonë dhe i siguron mburrje gjithë kombit. S'ka se si të mos krenohesh me "Kodikët e Beratit" me "Beratinusin e Purpurt" të Shekullit VI! Si të mos ndihesh kryelartë me emra të shquar me famë evropiane si Muzakajt, Onufri, Qypriinjtë, ...Mandej vlerësimet dhe mbresat që kanë dhënë për Beratin personalitete, si: "Jam Onufri që vij nga qyteti i shumë ndritur i Beratit", Shtarus, tha: "Berati është i bukur, për të qenë përjetësisht i bukur". "Këto vlera, ky muze dhe qyteti i Beratit nuk ju përket vetëm juve por i përket gjithë njerëzimit" – Perez de Kuelar,...

Ju që do të jeni si vizitor të parë, do të mrekulloheni nga pamja panoramike dhe emblematike e

nim ata që i dhanë jetë këngës shkodrane dhe e ngritën aq lart.

Jetojnë ende të pavdekshmit File Gjeloşi 90 vjeçe, Shyqyri Alushi që tani ec me shkop, apo artistja e merituar Naile Hoxha që jeton në azil të pleqëve.

Mos i harroni ata, ju që organizoni koncerte kaq të bukura. Prania e tyre ia shton bukurinë këtyre veprimtarive".

Mes të pranishmëve të binte në sy edhe mungesa e studiuesit të mirënjohur shkodran të kësaj fushe z. Isa Alibali, të cilit Këshilli i Bashkisë së Shkodrës i ka dhënë titullin "Mirënjohja e qytetit." Megjithatë studiuesit Isa Alibali i morëm një intervistë jo për zhvillimin e aktivitetit, por për të marrë prej tij një informacion të shkurtër për lindjen dhe zhvillimin e këngës popullore qytetare shkodrane në kuadrin e emërtimit "Ahengu Shkodran".

"Ju falenderoj shumë që po më bëni pjesë të shkrimit tuaj dhe akoma më i nderuar do të isha po të isha pjesë edhe e asaj nate të mrekullueshme, por për mospjesëmarrjen time atje e dinë më mirë organizatorët. Megjithatë unë jam gjithnjë shpirtërisht në Shkodër.

Përsa i përket historikut të këngës shkodrane me pak fjal mund t'ju them se: Data e krijimit të ahengut shkodran, është shumë e vjetër. Orkestra e parë e njohur dhe me veprimtari të gjërë është ajo që krijoi Veziri i Shkodrës në vitin 1825, ku përfshiheshin: Mehmet Shllaku nga Vukatana (drejtues i saj), në violinë, Kralo Berati, i ardhur nga Berati, me këngëtar Halil Tophana, humorist i grupit Tuk Vasia dhe një me kavall e një me dajre (që nuk u dihen emrat).

Por kënga shkodrane është shumë më e vjetër. Unë disponoj këngë të kënduara në vitin 1700, kurse kënga më e vjetër që këndohet edhe sot është "Krisi topi" e vitit 1769, krijuar nga Molla Hysen Dobraqi. Këtë këngë deri vonë e kanë kënduar

Bik Ndoja e Shyqyri Alushi dhe është në repertorin aktual të këngëve. Më vonë Kasem Xhuri (1837-1887) bëri përpjekjet e para për reformimin e ahengut shkodran. Por ai që eci me mjeshtri në rrugën e kualifikuar të ahengut shkodran ka qenë Palokë Kurti me këngët e tij dhe me shoqërinë "Daullja" që pat krijuar. Puna e këtyre u pasua me mjeshtri nga Sait Hoxha, Kolë Gurashi, Mark Krajani, Ndreke Vogli, Hasan Preza, Paulin Pali, Shefqet Kruja, e shumë e shumë të tjerë, që bëjnë

drejtori i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" Z.Sidrit Lohja, i cili pasqyroi punën e këtij institucioni dhe objektivat e tij: "Qendra jonë ka patur një aktivitet shumë të ngjeshur këtë vit. Ne kemi si synim evidentimin, ruajtjen dhe kultivimin e vlerave artistike qytetare. Misioni ynë në të njëjtën kohë është edhe mbështetja e talenteve të reja duke i krijuar atyre mundësi që të promovohen.

Ishte „Ahengu Shkodran“ i cilësuar si një nga kryeveprat e trashëgimisë kultu-

rregullt, të pastër, ashtu siç është edhe vetë ajo. Sonte ishte vërtetë një atmosferë jashtëzakonisht e bukur, është një repertori i ahengut shkodran me të vërtetë i përsosur. Grupi i këngëtarëve dhe i kompleksit të vajzave dhe i djemve ishte i përkryer, sidomos në disa këngë të vjetra të Ahengut Shkodran.

Shkodra gjithmonë ka patur vlera të tilla që e them me bindje se nuk mund t'i ketë çdo qytet".

Në këtë mbrëmje të veçantë ra në sy edhe prania e bylbylit të këngës popullore qytetare shkodrane të madhit Bik Ndoja, që, ndonëse në një moshë të thyer, kishte ardhur si një shkodran i vërtetë me biçikletën e tij të dashur, duke u mirëpritur nga emra të njohur të artit e kulturës në Shkodër.

Kjo festë e vërtetë, organizuar në një mbrëmje magjike, ngjasonte me dasmat tradicionale shkodrane që bëheshin dikur në oborre, ku ashikë e dashamirë të këngës rrinin me orë të tëra për të shijuar magjinë e ahengut shkodran.

Meritë dhe vlerësim ka Bashkia e Shkodrës, si dhe Qendra Kulturore „Pjetër Gaci“, të cilët kishin menduar ta organizonin atë si një stafetë e interpretimit të këngës popullore që vazhdon nga më të vjetrit te të rinjtë, në mënyrë që të përcillet brez pas brezi dhe të mos humbasë kurrë, duke e konsideruar atë si një repertori të hapur që nuk mbyllet asnjëherë.

Për përgatitjen e tij u angazhuan poetë dhe kompozitor të njohur të qytetit.

Ky takim kaq i bukur u mbyll me fjalët e moderatores Gentiana Dani: „Në Shkodren tonë të gjithë këndojnë“ dhe për tu takuar sa më parë u bë urimi: „Për çdo kënd, ju shkoftë jeta me aheng“.

Pergatite nga Ramazan ÇEKA  
e Osman KAZMAJ, Shtator 2014



një listë të gjatë e pa fund.

Duhet evidentuar Ramadan Sokoli, si një ndër krijuesit më të mëdhenj të këngës shkodrane, që i përket edhe ai grupit të kompozitorëve me shkollë.

Ka shumë vite që shoqata "Dashamirët e këngës shkodrane" ka bërë një punë të shkëlqyer për mbajtjen gjallë të këngës shkodrane".

Rreth këtij aktiviteti u prononcua edhe

rore shpirtërore kombëtare që u prezantua për të dytin vit radhazi me këngëtarët më të mirë të këngës popullore qytetare".

Më pas këngëtar Bujar Qamili „Mjeshtër i Madh“, si gjithmonë i qeshur, por edhe i „gojës“ tha: „Është kjo këngë që na ka rritë, na ka edukuar. Kuptohet se, që nga brezi i këngëtarëve më të vjetër, ne jemi përpjekur që këngën popullore qytetare shkodrane ta mbajmë ashtu, të

Mangalemit që është si kurorë e artë në kokën e një Missi. Kur të e vizitoni qytetin dhe Kalanë, do të njiheni me Muzeun Kombëtar "Onufri" - ju mund të njiheni me të gjithë mjeshtrit e ikonografisë shqiptare: Onufri, Nikolla, Onufër Qiprioti, K. Shpataraku, Dinastinë e piktorëve Katro e Çetiri. Njëherazi, ju do të mund të vizitoni disa nga perlat e arkitekturës dhe pikurës bizantine e post bizantine që ndodhen brenda mureve të Kalasë dhe lagjeve muzeale që janë të mbuluara me afresket e piktorëve anonimë. Berati lexohet si një libër me poezi, kundrohët si një pikurë moderne, dëgjohet si një simfoni... Berati ju ç'lodh, ju fisnikëron, ju bën të ndiheni si në shtëpinë tënde dhe nga vizitor të kthehesh në banor të tij. Kënaqësinë dhe mbresat e pashlyeshme do t'ju shtojnë banorët e urtë, të mençur e mikpritës të Beratit... Shkurt, jeni në qytetin e bardhë- me zemër të bardhë. Uroj të kaloni sa më bukur në Berat!

Ato që i potencoi kryetari i bashkisë, ditët në vijim i përjetuam. Madje edhe shumëçka u njoftuam, i vërejtëm dhe i përjetuam, sidomos ngrohtësinë mirëprirëse të banorëve. U njoha edhe me shumë seminarist tjerë, që më parë nuk njiheshim! Shumica nuk ishin vetëm thjesht mësues të shkollës shqipe në diasporë, por bartës të aktiviteteve kombëtare e kulturore që zhvillohen jashtë atdheut, si krijues, autor librash, këngëtar e kompozitor, gazetar, regjisor, skenograf, xhirues, etj. U njohëm në mes vete edhe me gazetaren e radio Athinës, programi në gjuhën shqipe Bardha Mançe, duke e krijuar një miqësi të ndërsjellë. U njoha me Hazirin, Linditën, Muratin, Luizën, Dardanin, Lebiben, Alferdin, Julianen, Qerimin, Almen, ... u takova pas disa vitësh me miqtë e vjetër Ramadanin e Milaimin, etj.

Çdo ditë paradite ishim në seanca plenare ku moderoheshin nga Nuhi Gashi (MASHT e Kosovës) dhe Rozalba Merdani (MAS e Shqipërisë), Bexhet Arbana e Marinella Duri. Në këto seanca ligjëruan: Liri Qoshi, Blerta Avdia, Gerti Janaqi, Erida Koleci, Ragip Gjoshi. Ndersa edhe vet seminaristët paraqiten ligjërata, promovuan libra e dokumentar, si: Arian


## GRUPI I VEPRIMIT LOKAL "BJESHKET E NAMUNA" NE VALBONE

Me datën 15-16 tetor 2014, Grupi i Veprimit Lokal "Bjeshkët e Namuna", ishte në Valbone, në një seminar, **Majat Shqiptare dhe Grupi Vendor i Veprimit "Bjeshket e Namuna"**, në baze të projektit "Mbrojtja e agro-biodiversitetit në zonat rurale të Shqipërisë"- CABRA, e financuar nga "giz", një bashkëpunim gjerman.

### Objektivat e këtij seminari ishin:

1. Këmbim përvoja dhe mendimesh me të gjithë anëtarët e deritanishëm.
2. Zgjerim i GVV me Specialiste të Mjedisit dhe Biznesit, edhe nga administratat vendore në Qark dhe në Komunë, që tashme mund të ristrukturohen.

Melonashi, Abdurrahim Ashiku, Kemajl Çallaku, Rifat Hamiti, Flutura Tafilaku, Driton Kajtazi, Dashmir Zaçe, Nexhmije Mehmetaj, Ina Arapi, Rexhep Rifati, Hazir Mehmeti, etj. Seancat mbaheshin në



Mangalemi-Lagje e një mbi një dritareve...

Qendrën Kulturore "Margarita Tutulani" dhe në UNIVERSITETIN E BERATIT. Në fund të seminarit për vijuesit, u organizua ndarja e CERTIFIKATAVE, të nënshkruar nga Lindita Nikolla -ministre e Shqipërisë, dhe Ramë Buja -ministër i Kosovës. Të pranishëm ishin zyrtar të lartë, si: zv. ministri në detyrë Nehat Mustafa, Azem Gurikëshilltari i lartë në MASHT-in e Kosovës, Imer Avdiu nga Ministria e Diasporës, etj.

Në orët e mbas ditës organizoheshin veprimtari shoqërore-kulturore nga Bashkia e Beratit. Ndërsa mbas përfundimit të darkës, organizoheshin mbrëmje shoqërore me muzikë beratase, por edhe argëtime nga muzikanti tani më i njohur për seminaristët edhe nga vitet e kaluara, Dardan Gashi nga Prishtina që jeton e vepron në Gjermani. Në këto mbrëmje argëtuese që zgjasnin deri në orët e vona të natës, nuk mungonin as batutat, poezitë, monologët e dialogët nga vet seminaristët, ku spontanisht krijoheshin spektakle në vete...!

Nga qendra kulturore "Margarita Tutulani" e deri te Hotel Tomori e Universiteti i Beratit, dhe anasjelltas duhet përshkruar Bulevardin REPUBLIKA. Na u deshtë ta kalojmë disa herë për ato ditë, i cili ndonëse kryheshin punët e rikon-

struimit, hasnim në njerëz shumë bujar e mikpritës, duke na nderuar e respektuar, madje edhe vet punëtorët që kryeni këto punë. Derisa në orët e mbrëmjes përgjatë kësaj rruge zhvillohej edhe shëtitorja

me një numër të konsideruar pjesëmarrësve të moshave të ndryshme.

Në **Galerinë e Arteve "Edëard Lear"**, që ishte fare pran qendrës kulturore u njohëm me ekspozitën e artistin Agron Polovina, ku ishte pjesëmarrës edhe vet artisti. Gjithsecila pikurë kishte vlerën e vete, ndërsa ajo e Babë Dudë Karbunarës më bëri përshtypje, si mësues dhe si delegat i shpalljes së Pavarësisë me 28 nëntor 1912 në Vlorë së bashku edhe me tre personalitete tjerë nga Berati.

**Mozeumi Kombëtar Etnografik**, është një vend shumë tërheqës, i vendosur në të djathtë të rrugës që shkon për në kala. Mozeumi përfaqësonte një banesë me arkitekturë popullore beratase, tri shekujllorë, dy kateshe, tipike e treves beratase. Në muzeum janë imituar gjitha objektet e vegla që janë përdorur nëpër shekuj, si rruqica me dyqane, kazanit i rakisë, mëngra e ullirit, etj. Janë format e dhomës së pritjes së fshatit, kuzhina, dhoma e pritjes për qytet, veshjet tradicionale, veglat ushqyese, etj. Të gjitha këto pamje shoqëroreshin me shpjegimet e ciceronit dhe përgjegjësve tjerë të Mozeumit.

**Kalaja** është monumenti arkitektonik më antik i qytetit, që ndodhet në pjesën e sipërme në formë të trekanshit. Ajo

ta, biznese dhe përfaqësues komunash të Qarkut Kukës dhe Shkodër. U drejtua nga koordinatori dhe këtij projekti, zonja Shpresa Smajli dhe ligjëruesi i saj Ali Lacej.

Pas një vendosje e mire në hotel



është një kombinimi epokave dhe stileve të ndryshme: Romantike, Bizantine, Shqiptare, Otomane. Aty hasesh në objekte të ndryshme të banuara e të pa banuara, kisha e xhami të ruajtur e të shkatërruar nga vet koha. Është një nga kështjellat më të mëdha të banuara, ku sipas statistikave banojnë rreth 350 familje...

**Mozeumi Kombëtar Onufri**, i vendosur në ambientet e kishës "Fjetja e Shën Mërisë", në kala në vitin 1986. Onufri është personalitet për beratasit, është njeri prej mjeshtrëve të pikurës shqiptare të shek. XVI-të, Koleksioni i muzeut, sipas ciceronit, përbëhet nga 173 objekte të përzgjedhura, ku 106 janë ikona dhe 67 objekte liturgjike. Autorët këtyre veprave janë piktorë shqiptarë të shekujve XIV - XX-të si, Onufri, Nikolla, i biri i Onufrit, Onufër Qiprioti, David Selenica, Kostadin Shpartaku dhe Çetirët. Ngjyra e këtyre veprave në një ekspozitë në Paris janë vlerësuar shumë nga kritikët e artit...


Berati ka shume karakteristika të veçanta, të cilat janë mrekulli në vete. Trojet e Beratit, sipas arkeologëve kanë qenë të banuara nga njerëz të civilizuar që nga shekulli VII para erës sonë. Tani janë tri lagje kryesore: Lagjja Mangalem, Kala dhe Goricë. Ka disa shkolla të mesme, Universitetin. Ka lumin Osum që kalon nëpër Berat, mbi të cilën është Ura e Goricës e gjatë rreth 130 m, që është një nga monumentet e kulturës dhe të arkitekturës së Beratit dhe njëkohësisht një nga simbolet e tij, e ndërtuar fillimisht nga druri, mandej nga guri dhe së fundit e rindërtuar nga betoni. Ka disa Sheshe ndër ta është Bulevardi "Republika". Banorët beratas iu takojnë tri konfesioneve fetare që gjithmonë kanë pasur tolerancë e respekt të mirëfilltë në mes vete: ortodoks, katolik dhe islam, ku janë edhe bektashinjët. Kanë objekte fetare, si kisha Shën Triadha dhe Shën Mëhilli. Nga xhamit më të njohura janë: Xhamia e Beqarëve dhe Xhamia e Plumbit.

Në vitin 1961 Berati u shpall zyrtarisht qytet muze kombëtar. Ndërsa nga 8 korriku 2008, Berati është qytet i mbrojtur nga UNESCO. E përfundojë këtë reportazh, dhe jam skeptikë se nuk e kam thënë meritoren për **Beratin - Qytet i 1001 mrekullive!**

"Margjeka"-Zic, në Qendrën Multifunkcionale Valbona, ditën e pare u zhvillua seminari. Në fillim, nga zonja Shpresa na u bë prezantimi i projektit. Më pas përsëndeti kryetarja e Grupit, zonjusha Merjeta Gjogecaj dhe pastaj secili pjesëmarrës beri prezantimin e vetvetes dhe punën e bere të deri tanishme. Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" u përfaqësua nga kryetari i saj, Ndue Sanaj dhe anëtarë i shoqatës, Luigj Ujka.

Në ditën e dyte, u diskutua mbi prioritetet e grupit në të ardhmen në idenë e këtij projekti. Grupi i Veprimit Lokal "Bjeshkët e Namuna" kanë pika të përbashkëta me projektin CABRA, prandaj bashkëpunimi së bashku është një domosdoshmëri e kohës. Mbi bazën e këtij projekti në Komunën Lekbibaj, me datën 25 tetor 2014, do të behet një përgjithësim i grupit. Prandaj, anëtarët e grupit duhet të jene më të përkushtuar për të realizuar së bashku prioritetet e dala nga ky seminar.

Përgatitë nga Luigj Ujka





*Lin Delia*

## PIKTORI LIN DELIA, PAS 60 VITESH NË SHQIPËRI

Midis shumë veprimtarive që u organizuan në kuadrin e vizitës së Papa Françeskut në Shqipëri, ishte dhe hapja e ekspozitës me veprat e piktorit të njohur Lin Delia-Nderi i Kombit, në Galerinë Kombëtare të Arteve në periudhën 17 shtator deri 5 tetor 2014. Një numër i konsiderueshëm pikturash ku spikatën portretet dhe peizazhet ishin në fondin e kësaj ekspozite. Piktori Lin Delia për fat keq për herë të parë është në atdheun e tij, para artdashësit shqiptar, ndonëse veprimtaria e tij në disa vende të Evropës është mjaft e njohur. Kurator i ekspozitës ishte z. Gjon Radovani, njëherazi dhe zv. Ministër i Zhvillimit Urban. Ekspozita pati vizitorë të shumtë dhe veprat e ekspozuara u pëlqyen.

Piktori Lin Delia, ka lindur në Shkodër në vitin 1926. Është larguar nga Shqipëria në vitin 1948, për në Itali ku është shkolluar dhe ka zhvilluar thujtë të gjithë veprimtarinë e tij artistike. Lin Delia, ka ndërruar jetë në vitin 1994 në Itali duke lënë një galeri të madhe të pikturave të tij, në shume vende të Evropës. Disa nga veprat e ekspozuara te fotografuara po i botojmë.

Teksti dhe fotot, Gjon Fierza



### REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra  
Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

